

INTERVISTË ME LUMTURIJE (LUMKA) KRASNIQIN

New York | 12 mars, 2017

Kohëzgjatja: 143 minuta

Të pranishëm:

1. Lumka Krasniqi (E intervistuar)
2. Anna Di Lellio (Intervistuesja)
3. Rexhep Myftari (Intervistuesi/ Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Rexhep Myftari: Na tregoni emrin tuaj, ju lutem?

Lumturije (Lumka) Krasniqi: Unë quhem Lumturije Krasniqi, përndryshe të gjithë me njoftin me emrin Lumka Krasniqi. Jam e lindur me 13 gusht, në vitin 1964, në Pejë. Fëmijëria ime nuk asht' fëmijëri sikur zakonisht e fëmijëve tjerë të asaj kohe të moshës sime kur unë kam lindur, sepse kam kaluar në disa faza, disa vështirësi të cilat janë ngërthy me vështirësitë familjare që kanë ndodhë në atë kohë, në kohën kur unë kam lindë. Shkollën fillore unë fillimisht e kam kry në një fshat, fshatin Jabllanicë e Vogël, në Klinën e Pejës, ndërsa prej vitit të dytë edhe deri në klasën e tetë e kam përfunduar në shkollën fillore "8 Marsi", në Pejë. Po them klasën e parë e kam përfunduar në Jabllanicë dhe dua ta lidhi pse unë e kam kry klasën e parë në Jabllanicë.

Në vitin 1964 kur unë kam lindur, babai im në atë kohë ka qenë ish i burgosur politik... asht' arrestuar për shkaqe politike e sidomos dihet për... kundër regjimit të asaj kohe. Dhe kështu, qëkur asht' kthyer baba në vitin 1968, '69-të më falni, atëherë në atë kohë ai nuk ka pasë mundësi të gjejë punë në asnjë vend tjetër si mësues që ka qenë përpara arrestimit. Kështu që, ju ka ofru mundësia të punojë në një fshat aty afër Pejës, Jabllanicë e Vogël, në shkollën në atë kohë "Mosha Pijada". Kështu që, ai për me na afriu, meqë ishim... na kishte mungu disa vjet gjatë burgut që ishte i burgosur, na murrë neve familjen edhe shkum për të jetu në fshatin Jabllanicë, aty ku edhe punonte babi.

Kështu që, unë isha në moshën pesë vjeçare në atë kohë edhe doja që të shkoja në shkollë, meqë në Pejë ku jetonte gjyshja me gjyshin aty apo shtëpinë ku e kishim neve, krejt shokët dhe shoqet e mija shkojshin në shkollë ata të gjeneratës teme, edhe pse ishin pak ma të mdhaj gjashtë vjet, shtatë vjet, doja edhe unë të shkoj në shkollë sikur ata. Kështu që, pastaj baba më murrë dhe më regjistroi në klasën e parë veç sa me provu me ma hekë atë merakun e shkollës edhe më regjistroi në vitin e parë në Jabllanicë në shkollë ku ishte vet mësues i klasës së parë. Kështu që, më morri mu dhe fatmirësisht unë tregova sukses dhe e kalova klasën edhe vitin e dytë, të klasës së dytë domethënë fillore u ktheva në Pejë, ku u kthyem gjithë familja dhe baba vazhdoi të punonte, por udhëtonte prej Pejës në Jabllanicë çdo ditë derisa edhe asht' pensionu, meqë gati 40 vjet ka punu në të njëjtin vend.

Tash dua të ndërlihem me familjen teme pak. Familja ime rrjedhë... asht' një familje si e quajmë na

në Kosovë, familje muhaxherësh. Babgjyshi im ka lind në Kosovë, mirëpo familja e katragjyshi im ka lind në rrethin e Leskovcit aty ku, atëherë në aso kohe kanë qenë të banuara prej popullit shqiptar. Domethënë, kanë qenë vende ku kanë banu neve dhe prej represionit dhe gjenocidit që kanë bo serbtë në vitin 1878, menjherë mbas lidhjes së Prizrenit, dyndjen dhe gjenocidin, ata janë familja ime, të parët e mi janë detyru të kthehen në Kosovë, në fakt të kthehen në Shqipëri. Dhe kështu që, kalvari i familjes time Shqipëri-Kosovë ka zgjat disa herë.

Në Shqipëri deri në vitin... deri pas Luftës së Dytë Botërore kanë jetu familja ime, baba, gjyshja, gjyshi dhe halla. Aty më ka lindë baba, më ka lindë dhe halla. Baba më ka lindë në Durrës në vitin 1934. Janë kthi mas luftës dhe ka vazhdu, pastaj baba ka vazhdu shkollën... janë kthi nga Durrësi në Pejë. Fillimisht në Vitomericë në fshatin afër Pejës, pastaj mbas një kohe shumë të shkurtë kanë kalu të jetojnë në Pejë. Kështu që, prej atëherë e deri me ditën e vdekjes dhe tash e mbas familja ime jetojnë në të njëjtin vend.

Baba im ka kry, me profesion ka qenë mësus. Në atë kohë me qenë mësus, mësus i respektum, mësus në atë kohë që ka jep shumë për çështjen kombëtare, çështjen e arsimit dhe në vitin 1964 baba im arrestohet, arrestohet nga policia, nejtse nga okupatori, arrestohet nga pushteti i atëhershëm. Si pjesëtar i grupit të “Lëvizja për bashkimin e Shqiptarëve” ku në atë kohë bënë pjesë Adem Demaçi, në atë grupin e Adem Demaçit, por ky ishte në atë grupin e Pejës, ku ishte bashkë me Ramadan Shalën, Sylë Shalën, Remzi Balokun, Ahmet Zekën, Ejup Kastratin e këta. Por, një veçanti po du me cekë këtu, çka asht’ që për mu asht’ shumë me randsi. Unë kam lindë në gusht të 64-tës, ndërsa në qershor të po të njëjtit vit, derisa nana ime shtatëzane, babën tem e kanë arrestu, domethanë unë isha akoma pa lindun, kështu që jam fëmija i pestë i familjes. Domethanë, jemi tre vllazën, janë tre vllazën edhe dy motra. Kam edhe një vlla pastaj, ka lindë mbasi asht’ kthi baba prej burgit, vllavi i vogël, por në atë kohë unë isha ende e pa lindun.

Dhe kështu që, nana jeme ka pasë një jetë shumë të vështirë. Në një anë me katër fëmijë, pastaj linda unë, anën tjetër ka pasë shtypje, presion, presion psiqik, pastaj presion besa ekonomik në atë kohë, s’ka pasë kush punon në atë kohë. Kam pasë gjyshin dhe gjyshen, por kanë qenë shumë të vjetër dhe ata kanë qenë të lodhun, dhe linda unë. Por, çka asht’ shumë, shumë veçanti e ksaj asht’ që unë kam lind ditën kur baba im asht’ gjyku. Domethanë, seanca e fundit kur osht’ bo që e kanë shpall aktgjykimin, unë atë ditë kom lind. Kështu që, dy-tri seanca përpara paraprake që janë, ato qysh shkojnë, seanca publike kanë qenë, gjykimi si thojnë gjykimi publik. Nana jeme atë ditë nuk shkon për shkak që linda unë, domethanë unë kom lind në shpi, jo në spital.

Edhe shkon gjyshja edhe gjyshi, shkojnë në seancë edhe e sheh baba prej ku ishte, aty e sheh që nana mungon në seancë edhe veç e bon me sy, tregon gjyshja edhe i thotë se çka, i thotë gjyshja veç kështu {bën me shenjë kah barku} demek që a din ka lind edhe e pyet se çka se s’dinë, edhe ajo gjyshja veç i tregon kështu {prekë me dorë veshin}. Domethanë, që vajzë dhe unë isha e dyta. Babi, si tregon çdoherë, thotë, “Shumë jom gzu.” Dhe për ata edhe e kom emrin Lumturije. Emrin kush ma ndon Lumturije, mbasi kryhet seanca, gjykohet babi e krejt, Mustafë Radoniqi tash një avokat shumë i

njohur në Kosovë e një aktivist për të drejtat dhe mbrojtjen e lirive të njerëzve, atë e kishim kojshi, ish i ri. Në atë kohë ishte student edhe shkon i thotë babës para se ta marrin babën kur të kryhet gjykimi, i thotë, “A ma len Mehmet mu të ja ndoj emnin”? I thotë, “Po, qysh [jo]?” Thotë, “Lumturije dojna me ja vnu emrin meqë sot jemi të lumtur”. Kështu që, prej atëherë më pagëzojnë me emrin Lumturije.

Më kujtohet, më kujtohet mbasandej mbas sa kohe edhe vizitat e babës kur... këto më lajnë shumë mbresë të madhe më kanë lanë në burgun e Nishit. Kujtimi i parë dhe shumë i paharrum, isha gati katër vjeç në atë kohë kur... shumë mirë më kujtohet, e kam kujtim shumë të freskët kur shkum me vizitu babën. Atëherë, në atë kohë nana punonte punë të dorës për me na veshë, me na mbathë se kur shkojshim në burg atje dojke nana e baba e gjithë që na kur të shkojmë, me shku të veshun mirë, me shku shumë krenar që mos me thanë ata, policia, të burgut që, “Sa gjynah, si janë ba kta”, me pasë mëshirë. Kështu që, unë isha shumë bukur e veshun edhe më kujtohet i kom pasë një [palë] hollahopke të bardha e kur e shoh babën që larg aty kur na lejojnë me hy në oborr, baba ishte ulun me një si karrige, ulun aty t’u na prit neve, unë kur e shoh edhe gzohna edhe ngaj. Kur ngaj, domethanë vrapoj edhe rrzohna edhe e shkyj atë hollahopken që menzi e kisha prit me vesh, e shkyva, nuk m’u dhimt gjuni që e vrava po m’u dhimten hollahopket. Kështu që, atëherë qajo më kujtohet shumë, atë kujtim kurrë s’e harroj, ndër kujtimet në vizitën e babës.

Rexhep Myftari: A po na tregon baba juaj për çfarë akuze është burgosë edhe qysh ka ndiku në rininë tuaj?

Lumturije (Lumka) Krasniqi: Baba im osht’ akuzu, akuza e tij ka qenë si e quajtsin ata kundër revolucionare. Ai ka qenë me një grup që quhej “Grupi për Çlirimin dhe Bashkimin e Shqiptarëve” kudo. Domethanë, për çështje politike, çështje politike kombëtare, e kjo ka ndiku që në familjen tonë të jemi të frymëzuar kombëtarisht, të edukuar kombëtarisht dhe që deri me ditët e sotme akoma e kemi atë që jemi lind dhe do të vdesim për çështje kombëtare.

Rexhep Myftari: Na trego për jetën tande në, jetën tande në Pejë edhe si ka ndiku burgosja e babës?

Lumturije (Lumka) Krasniqi: Jeta ime nuk ka qenë shumë edhe si fëmijëri, ka qenë e vështirë, si thashë edhe ma herët. Mirëpo, kjo ka ndiku, arrestimi i babës ka ndiku në mentalitetin e disa njerëzve në aso kohe, neve na kanë qujt si njerëz, jo të mirë, jo lojal ndaj pushtetit të atëhershëm. Na akuzojshin edhe fëmive që na kemi faj. Na nuk dishim në atë kohë se çka asht’, çka po ndodhë në familje, çka po ndodhë në shtet, për çka ka shku baba në burg, na nuk dishim, veç e dishim që baba nuk asht’ në shpi, kaq, edhe asht’ në burg. Kjo ka ndiku, për shembull kur edhe ngarkesë edhe na lëndojke kanjiherë ky fakt.

Kur delshim me luft për shembull në lagje, në atë lagjen ku ishim me moshatarët tonë, më fëmijët tjerë të lagjes, kur delnim na, familjet e atyne fëmive, baba, nana ose vllaznit, motrat ma të mdhaj, i merrnin edhe i futnin fëmijtë e vet në shpi dhe thojshin, “Mos luni se këta janë fëmijtë e shpijunave”. Kështu që neve, na u prekshim, nuk dishim as çka asht’ shpijuni. Në atë kohë edhe shkojshim i tregojshim gjyshit, “Pse na jemi fëmijtë e shpijunave?” Thojke babagyshi, “Kur të rriteni keni me

kuptu. Kur të rriteni do ta kuptoni, ju keni mu mburrë, keni me u mburrë me atë se për çka asht' baba ju j në burg, ka me ardhë koha”.

Edhe në shkollë, në shkollë masandej ma vonë, ma vonë në shkollën fillore “8 Marsi” ku unë e vazhdova klasën e dytë dhe deri në klasën e tretë kemi pasë... pastaj veç filloi mentaliteti i mësuesave, njerëzve atëherë veç u ngrit, u vedijësun njerëzit për çështje kombëtare, fillunë atëherë veç vedijësimi, filloi në nivel.... E ma vonë, domethanë ma vonë në shkollë kur isha kisha një përkrahje jashtëzakonisht të mirë të mësuesave, më dojshin mësuesit, na afroshin neve. Më kujtohet një mësuese e muzikës, një mësuese e muzikës ndjesë pastë Shyqerie Imeri, ajo ka qenë një mësuese jashtëzakonisht e mirë dhe shumë atdhetare, edhe pse ka qenë veç e muzikës. Më kujtohet edhe nana tregojke thojke, se sa ish baba në burg ajo vike te na, “Në shpi vike te unë edhe u kudjeske për fëmi. A ki nevojë diçka?” Pse ishte se vllaznit ma të mdhaj që i kisha, ishin në atë shkollë aty ku jepke mësim aty ajo edhe tregonte që sa, sa u kujdes ajo mësuese për neve gjatë, baba kur ka qenë në burg gjatë kohës.

Kështu që, kjo ka ndiku shumë domethanë në një anë shumë pozitivisht, por në një anë në atë psikologjinë e fëmive na ka ngarku si fëmi. Mirëpo, t'u u rritë veç na u vedijësum edhe u frymëzum shumë për çështje kombëtare. Kështu që, kur u kthy baba nga burgu më kujtohet si sot, ka qenë maji, s'um kujtohet muji [dita], por e di që në maj asht' kthy edhe veç me kujtohet kur asht' kthy. Kemi dalë me prit në stacionin e trenit në atë kohë, se kur ra Rankoviqi gjoja Tito jepi amnisti për krejt të burgosurit politik, amnistoi këta edhe kështu që baba edhe grupi i tij dulën në maj, dikush ka dalë dy ditë përpara, dikush dy ditë ma vonë. Mirëpo, baba ka dalë me një grup të Pejës, ka dalë në të njëjtën kohë. Edhe më kujtohet pritja tyne aq madhështore në stacionin e trenit, kanë dalë me muzikë, kanë dalë me instrumente, me... a asht' darsëm a çka asht'? Si sot më kujtohet.

Edhe prej pastaj e kishim një dhomë e kish mbaru shpejt babgjyshi, se a din sikur dhomat e pritjes së burrave, sikur në atë kohë si te shqiptart që asht' si odë e burrave, veç në qytet. Vijshin njerëzit me vizitu babën, me pa, me uru. E mu më kujtohet baba gjithë kohën në prehen më mbante, gjithë kohën e gatë. Domethanë, zatën ai moment asht', qajo kohë asht' frymëzimi im, frymëzimi im kombëtar. Se s'e dija kta njerëz për çka po vijnë, pata fillu veç me u msu me atë rreth njerëzish. Edhe kështu që ma vonë vinin këta shoktë e babës, shumë këta ish të burgosun që ishin me babën, vishin dhe zakonisht atje në Jabllanicë ku jetonim në atë shpinë, aty u mbledhnin mbas burgut, u mbledhnin gjithë. Aty i pata taku shumë njerëz që sot më kujtohen nashta nja dy i kom pa e mo s'i kom pa, për shembull Hyrije Hana, Enver Tali, Kadri Kusari, gjithë këta vinin, Ahmet Zeka, Seladin Daci, Ramadan Shala, këta gjithmonë vinin te na edhe u takonin aty për kur bojshin ahengje {bën me duar}, ata veç ahengje, darka, rrinin, pinin, muhabet. E aty më kujtohen ato momente shumë të mira të fëminisë, se gjithë ata çka ishin kur më shifshin mu më thojshin, “U sa u rrite ti? Sa u rrite ti. Si po shkon koha na që ishim në burg kur jemi gjyku.”

Mbasandaj, kur fillova... frymëzimi im asht' edhe për shembull, në shpi prej babës kur, e di në shpi na nuk kishim ndonjë, për shembull lluks të madh familjar, shtëpiak, orendi, nuk kishim, por te na baba

çka ka pasë e ka pasë... i vetmi, e vetmja veprim që bonte baba ka qenë blejke libra në atë kohë mbas burgut. Edhe e ka pasë formu një bibliotek, një bibliotekë domethanë bibliotekë jo të vogël, por bibliotekë shumë të madhe, familjare e kemi pasë, ndoshta një dhomë, një dhomë si sot më kujtohet ka qenë plot libra. Në atë kohë baba në vend që me ble për shembull... i thojke edhe nana, “Po blej bre burrë ndonjë kauq a ndonji diçka”, thojke, thojke, “Hajt se këto blehen”, blejke në kredit edhe blejke libra. Më kujtohet si sot vishin librat me ato kombit e mdhaja kur blejke baba, merrke kredi.

E kështu që ai ka qenë shumë i lumtur kur secili... aty u pat’ bo si bibliotekë, u bo si bibliotekë e qytetit, e fakultetit, e familjes së ngushtë, familjes së gjanë në fakt. Vishin fëmija, vishin të rinjtë, merrshin libra, lexojshin, i kthejshin, u bo si bibliotekë publike. Kështu që, prej atëhershmit më ka mbetë ajo që kam lexu shumë, për shembull Sterjo Spassen e kom lexu në klasën e katërt fillore, gjithë Sterjo Spassen. Mandej, kur dul Jakov Xoxa, kur e qiti botimin e parë në Kosovë, kur u botue, e botoi “Rilindja” më kujtohet isha në klasën e shtatë. Baba jo që na detyrojke, por ashtu na frymëzojke që duheni më lexu, edhe i blejke, thojke, “Kta duhet ti me lexu tash.” Kështu që, lexojshim Jakov Xoxën, në klasën e shtatë e kom lexu, derisa Ali Pashë Tepelenën në klasën e shtatë asht’ dashtë me lexu unë, se duhet me ditë historinë.

Meqë baba ishte edhe historian edhe na detyrojke që të lexojmë sa ma shumë histori, sa ma shumë edhe thojke, “Ai popull që s’e din historinë e vet, nuk ka të ardhme. Kështu që, mësoje historinë edhe e mëson e ardhmja jote asht’ ma e ndritshme”. Nga kjo dhe... kështu që, unë e frymëzune edhe brenda familjes. Kur visha prej shkollës shiheshim brenda familjes s’kishim tjetër gja na në shpi edhe thojshin njerëzit, “Nëse doni me shku në Shqipni, shkoni të muhaxhert”, se neve muhaxherë na quajshin, “Shkoni të muhaxhert, se jeni si në Shqipni”, se gjithçka ishte me flamuj, me frymëzim, me muzikë shqip, me kaseta shqip, me çkado, televizioni shqiptar, tanë kohën qashtu edhe na jemi frymëzu.

Në vitin... shkollën e mesme, kur isha në vitin e dytë, në vitin 1981, fillunë atëherë demonstratat e para, kur tash veç dihet ato para sa 36 vjetëve u bo mo. Edhe më kujtohet si sot në shkollën, isha në vitin e dytë në shkollë teknike, në Pejë, edhe me 11 mars na veç morëm vesh diçka në radio, ndëgjum një lajm që janë ba disa demonstrata, por nuk dishim atëherë akoma çka janë ato, çfarë demonstrata. Dhe kishim, një profesor të gjuhës shqipe e kisha, fatmirësisht e kisha edhe kujdestar klase, ishte Xhavit Aliçkaj edhe ai i ndjerë. Ai ka qenë një ndër frymëzuesit, përveç babës, ka qenë frymëzuesi i dytë për çështje kombëtare edhe ai vjen edhe më thotë mu edhe disa shoqeve që ishim aty, ne ishim pak a shumë ma të dallume kombëtarisht, ishim nxanëse të mira, por edhe kombëtarisht ma të dallume, edhe ai po vjen e po na tregon, “A keni ndëgju se janë ba demonstrata?” Na i thamë, “Po kemi ndëgju, por çka janë ato, për çka?” “Qysh për çka?” Po na tregon, “Kshtu, kshtu, kshtu...”

Mbasandaj, me 26 Mars kur u banë ato demonstratat tjera në Prishtinë, të nesërmen u organizun edhe në Pejë kështu që na... unë në atë kohë e re isha me disa shoqe të klasës me një Zelfije Gashin, e kemi organizu disa shoqe edhe u veshëm, qaq sa kishim mundësi na, edhe dulëm demonstruam në ‘81-tën. Kështu që, të nesërmen me datën mbasandaj, me datën 31 mars kemi shku në Prishtinë në ato... me 1 prill ka qenë e madhja. Kështu që, unë u pata lëndu në Prishtinë në demonstrata, e pata pre dorën

edhe u kthyem. Unë isha me Zelfije Gashin në Prishtinë që shkum, shkum kishe me bo diçka na, kishe me marrë pjesë edhe na në demonstrata por s'bamë kurgjo, por veç murrëm pjesë. Unë u lëndova pak edhe asnjigja, u kthyem, s'murrë vesh kurgjë kurrkush.

Mbasandej, gjatë viteve, gjatë viteve kështu që vazhdova shkollën e mesme e kryva në Pejë edhe doja të studioja në Prishtinë. Në fakt, andrra jeme ka qenë me studiu në Zagreb, kisha andërr me studiu psikologjinë industriale, doja ta studioja. Edhe një ditë babi, edhepse kushtet nuk i kish për me m'çu me studiu në Zagreb tha, "Kqyre bija jeme," tha, "e vetmja mundësi e jotja për me studiu asht', t'kisha sugjeru fakultetin ekonomik në Prishtinë, kem nevojë për ekonomi, secili institucion, secili vend, secili kudo që shkon në botë ekonomisti asht' i kërkum, kështu që regjistroje ekonominë". Edhe e ndëgjova babën u regjistrova në ekonomi dhe të drejtën ta them falënderimi ma i madh për kta çka kom studiu asht' i babës sepse me të vërtet e kom gjetë veten aty tash ku jom.

U regjistrova, domethanë '82, '83 u regjistrova në Fakultet Ekonomik me vështirësi të mdhaja, me vështirësi sepse isha vajza e ish të burgosurit politik, e neve nuk kishim vend aty se ishim si "virus" i rinisë. Mirëpo, për me hy unë, për m'u regjistru duhej të jepsha provim kualifikues, provim pranues edhe me nota pesëshe. Në atë kohë notë pesëshe për me kalu, tani a muj m'u regjistru, a jo? Fatmirësisht unë e kalova [provimin] kualifikues edhe pranues, kështu që më pranun. Fatmirësisht më pranun në Fakultet Ekonomik si studente e rregullt. Mirëpo, vështirësia e parë që hasa gjatë studimeve kur fillova ishte sistemimi im në konvikt të studenteve. Shkova, unë konkurrova për me marrë konviktin e studenteve vitin e parë, kur shkova me marrë, me kqyr emrin a ma kanë pranun, sigurisht që jo.

Edhe, shkova tani ish ajo Lidhja e Studentëve ku duhej të informohesh për çdo gja, shkova edhe m'u informu se pse nuk ma kanë nda konviktin edhe pse isha studente e mirë, i kisha krejt kushtet, thanë, "Na ka ardhë një ndalesë prej, një referencë në fakt prej Pejës, Lidhjes Komuniste të Rinisë së Pejës që ti nuk guxon të jetosh në konvikt me studentët e tjerë për shkak që je çika e bla bla bla e ktina". "Okej". Atëherë unë ça boj edhe thashë, "Çka me vepru mbasandaj unë?" Tha, "Ti duhesh me shku në Pejë edhe me kërkun një letër, ki me kërkun me ta dhanë një letër për me ardhë me u regjistru, me marrë konviktin".

Unë atë ditë, të njëjtën ditë i hypi autobusit edhe kthehna për Pejë edhe shkoj menjherë në Lidhjen Komuniste aty, në Komitetin Qendror në Pejë. Edhe më kujtohet si sot, s'po jap emën, një ndër sekretarët e Komitetit edhe kërkoi takim me të, edhe më pranoi edhe i thom, "Pse kshtu, kshtu, kshtu", tha, "Edhe po ki ftyrë," tha, "ti me ardhë me kërkun," bash kshtu tha, "po ki ftyrë me ardhë me kërkun leje me jetu me... mirë që t'kena pranun aty në fakultet, t'kena leju m'u shkollu, se ju s'meritoni as me u shkollu". Atëherë, dola unë, por fatmirësisht një nga shoqet e mija që i kisha studente e kish marrë konviktin. Kështu që, banoja me ta ilegale në atë kohë, por banoja më ta në një dhomë por ilegale, jo e rregullt. Kështu që, vazhdova çdo vit në të njëjtën mënyrë derisa përfundova fakultetin.

Domethanë, si fëmije i babës të tillë ish i burgosur politik, njeri veteran i arsimit, njeri intelektual që tanë jetën e vet ia ka kushtu çështjes kombëtare, fëmija tyne kanë qenë të diskriminim. Domethanë,

unë si fëmi, vllaznit e mi që i kisha tre ma të mdhaj, kishin kry shkollën, nuk kishin të drejtë pune, s'ishin punësu. Motra jeme edhe ajo e regjistroi, studiojke anglisht edhe ajo pa mundësi shkollimi të rregullt, studente e rregullt por studente me korrespondencë studiojke anglisht ende, njëkohësisht edhe shkollën e lartë komerciale, por për me u punësu kemi qenë të diskriminim deri.... E vetmja, e para që asht' punësu në familje prej fëmive jam unë, atë në vitin 1989 në një kompani shtetnore, por me seli në Shkup, Maqedoni. Dhe ata u bartën në Klinikë edhe unë konkurrova aty edhe u pranua si kontabiliste në të njëjtën firmë, ku deri në masat e dhunshme kur erdhën që i mbyllën. Pastaj i mbyllën krejt organizatat shqiptare ku ishin, i mbyllën, edhe unë në atë kohë na heqën prej punës e kështu që vazhdova pastaj me punu privatisht, kontabilitet me mbajtë. Mandej, fillova me një organizatë tjetër ndërtimore si shefe e kontabilitetit kështu që ka vazhdu, profesionalisht kom punu shumë, por pa u nda asnjëherë çështjes kombëtare, aktivitetit tim.

Pjesa e Dytë

Tash po kthehem kah ajo në vitet '89-'90, atëherë kur filloi edhe aktiviteti im i madh, aktiviteti i madh në lëvizjen kombëtare, në lëvizje të çështjes kombëtare në Kosovë. Në vitin '89 në atë kohë veç filloi kur osht' formu Lidhja Demokratike, ato, filloi lëvizja e madhe, qata njerëzit fillun veç me u... domethënë pas minatorëve, pas mbylljes së minatorëve dhe në vitin '87-'88, atëherë fillun neve të vetorganizohemi në qytet në Pejë, rinia që e njëfishim njëri tjetrin. Na rinia për shembull që ishim, unë që i njëfisha, ai e kishte babën, ai nanën, familjarisht që e dishim që jemi të besueshëm, fillum edhe organizohemi të bashkohemi edhe të funksionojmë në atë mënyrë në atë kuptim ilegal.

Kështu që, në vitin '89 unë takohna me Angjelinën, një Angelina Krasniqi, Reshat Nurbojen, Jahja Llukën. Me këta takohem edhe fillojmë edhe organizojmë. Themelohet një, së pari themelohet Partia Parlamentare fillimisht. Unë nuk isha në Parti Parlamentare, por isha si aktiviste. Punoja në secilin parti, në secilin aktivitet ku ish, ku kish nevojë më ftojshin, më thirrshin për ndihma, unë isha shumë aktive në secilin aktivitet. Kështu që, pastaj viteve të '90-ta, po du me cek kur filloi vrasja, demonstratat në fillim të viteve të '90-ta, demonstratat në Kosovë, demonstratat e para të mdhaja në atë kohë, edhe në Pejë u vra Fatmir Ukaj. Kjo asht' ngjarja e parë që lidhet gjithçka me aktivitetin tim [të] asaj kohe e deri më sot, deri para luftës.

Fatmir Uka u vra në demonstratat e vitit 1990, domethënë viktima e parë në Kosovë. Ai njëkohësisht ishte edhe djali i dajës tem. Ishte i ri. Unë isha në demonstrata atë ditë. Ai u vra. Ishim të gjithë çka ishim na aktivista ishim të shpërndamë, dikush në një anë, dikush në një anë edhe ai u vra. Pa e ditë unë, nuk e disha a u vra, "U vra një njeri, një njeri u vra, u vra", nuk e di edhe tashti po shkojmë. Na shpërndanë krejt, "Kush asht' ai?" Kur po shkoj në spital unë ta shoh kush asht' ai që u vra, kur mora vesh që... e pash nanën tem aty, e pash vllaun tem, thmitë e dajës, "Kush u vra?" "Fatmiri". Po prej asaj dite e te mbas, ajo thymja, njëkohësisht thymja, por njëkohësisht edhe vullneti edhe njëfarë... një aktivizim i ndjenjave, domethënë për një punë, për një veprim ma të madh, për çlirim sa ma të shpejtë

kundër Jugosllavisë, kundër Serbisë së atëhershme.

Kështu që, u takova në vorrimin e Fatmir Ukës, u ba vorrimi, një ndër vorrimet e para të mdhaja, vorrim që nuk mbahet mend, nuk mbahet mend. Aty unë isha, nuk ishte që isha organizatore sepse ajo vetvetiu, ai vorrimi parë domethanë ajo vrasja e parë e sensibilizoi gjithë popullin. Ka pasë njerëz që kanë ardhë prej gjithë Kosovës, gjithë Kosovës në vorrim. Nuk mbahet në mend vorrimi i tij, nuk mbahet në mend. Kështu që, unë jo që isha organizatore, mirëpo qëllova e familjes isha edhe pak ma aktive edhe i kisha shoqinë, rrethin tim që kishim, kështu që e bamë njëfarë lloj, si më thanë, udhërrëfyes organizim e sipër vorrimin e Fatmirit. E aty mbasi, prej aty u takova me Serbeze Vokshin të ndjerën dhe Flamur Gashin. Aty u takum na në vorrimin e Fatmirit, mandej u takova me Verën, Vera Kolgjerën, Angjelina Krasniqi veç që ishim të njoftun, edhe masandej aty u takum edhe u shoqum.

Kështu që, në të njëjtën kohë u vranë edhe Ali Hyskukaj, Qamil Daci edhe këta ishin vra kështu që...Atëherë në të njëjtën, domethënë në ato kohë gjatë vrasjeve të këtyne rinisë tonë apo demonstruesve apo kushdo që dilte në rrugë vritej në atë kohë. U dha lajmi që... në televizion që shqiptarët po vrahen në mes veti, shqiptarët në mes veti, kështu që Fatmir Ukaj asht' vra, asht' në gjak dhe asht' vra nga gjakësori, e ka vra, nuk asht' vra nga policia po asht' vra nga gjakësori. Në fakt familja e Fatmir Ukës, domethanë baba, babagyshi, axha i babës tina asht' vra domethanë ka qenë në gjak dyzet vjet e ma përpara, por ai gjak pasiv që as nuk kanë vra as nuk kanë falë. Mirëpo, ajo nuk ishte ashtu, mirëpo dinin si më e lanë që shqiptarët po vrahen në mes veti.

Kështu që, aty gjatë vorrimit të s'di cilit kemi qenë, s'po më kujtohet, në kryeshnosh në fakt qysh ishin atëherë ngushëllime, unë me Serbezin po takohna edhe po më thotë Serbezi që, "Qeshtu, qeshtu, kanë fillu njerëzit, kanë fillu do pajtime të gjaqeve, kanë fillu". Serbezi ishte edhe ajo një ndër ato që ishte, edhe ajo kishte njëfarë plage shpirtërore, ishte në gjak me dikond e kështu që edhe ajo frigohej që mos po ndodhë diçka me familjen e saj. Edhe ajo po m'tregon, veç po m'tregon që kanë fillu disa lëvizje të para të pajtimeve, njerëzit ashtu kështu edhe unë s'e morra diçka si... e morra si shumë çështje të mirë, por jo që unë do të isha pjesë e atij grupi, asaj lëvizje se m'u dukej si nder i madh me qenë unë aty.

Por, një ditë Riza Krasniqi ai ka qenë edhe kojshi i imi përpara kur kemi jetu në një lagje me Rizën, po edhe kemi qenë si... e din ai se unë isha aktiviste dhe si familje e mirë me thotë, një ditë më thotë, "Lumka, qeshtu, qeshtu asht' formu një Këshill i Pajtitimit të Gjaqeve," tha, "do të ishte nder sikur ti të vishe me ne se kemi nevojë për disa njerëz me na ndihmu". Tha, "Ça po thush?" Thashë, "Ti mu po më nderon që po më fton në këtë grup, në këtë lëvizje". Kështu që, prej asaj dite e te mbas kemi qenë me një grup unë, Serbezi që punonim në Pejë, domethanë i përgatitnim rastet, i gjenim rastet. Riza në atë anë me nxënësit e vet, se ka qenë profesor, unë e Serbezi gjatë gjithë kohës hulumtojshim njerëz, hulumtojshim raste, unë punojsha në Klinë, hulumtojsha nëpërmes njerëzve ku ka raste, ku ka vrasje, ku ka....

Kështu që, gjatë gjithë javës na shkonim edhe finalizonim për shembull rastin e pajtitimit në një... për shembull të dillen ose të shtunën kur vinin edhe grupi i pajtimtarëve, profesorëve, atyne nga Prishtina

ose njerëzit që ishin shumë të njoftun edhe të nderum edhe pajtohej ose nuk pajtohej rasti, por kryesisht pajtohej. Kështu që, kjo ishte një ndër aktivitetet e miya që sot e kësaj dite asht' një aktivitet, një punë që ka qenë shumë nder për mu dhe e ndij veten shumë të lumtur sepse më duket që kam qenë pjesë e diçka që... diçka humane, jo veç kombëtarisht, por edhe humanitet njerëzor sepse pak a shumë asht' ndërprerë vrasja në mes njerëzve, jo veç për shembull dy familje, por aty ka shku zingjir. Nji familje me kohë, sot, ai unë ty, ai ato kështu që jam shumë, shumë krenare që kom qenë pjesë e atij Këshilli.

Rexhep Myftari: A mund të na tregoni për ndonjë rast të veçantë të pajtimit të gjaqeve?

Lumturije (Lumka) Krasniqi: Po, ka raste, kom qenë në shumë raste, por një rast specifik për shembull ku muj ta veçoj, që e veçoj edhe me kujtohet shumë mirë edhe e ndij veten pak ma krenare që kom kontribu në atë gjakmarrje, asht' rasti në familjen e dajve të mi. Axha i nanës teme ishte vra dikur shumë ma herët, siç e ceka ma herët, xhaxhai i Fatmir Ukës ishte vrarë edhe kishte lanë vetëm nji djalë. Ishte vrarë në të njëjtin fshat, se familja e nanës teme ata vijnë nga fshati Lumbardh i komunës së Pejës. Edhe aty janë vra, punë e sipër në tokë sikur qysh janë vra çdoherë. Edhe ai gjak nuk asht' marrë se ky ka lanë veç nji djalë, djali ka qenë i hasretit, familja tjetër janë mundu që mos ta ashtu ta mbushin mendjen që jo duhesh m'u vra, jo kështu, jo me nxjerr gjakin. Mirëpo, ai kur asht' rritë edhe u ba që dojke kishe me nxjerr gjakun, por me kohë u martu, u bo me fëmi edhe ai gjak sikur u pashit.

A bon qetu me ndërpre? Ndërpreje pak ma ashtu se pak u... (fillon e qan)... prej kuhit?

Rexhep Myftari: Filloja prej... a mundesh me na tregu për familjen si ka qenë jeta juj në pajtimin e gjakut që keni pasë në familjen tuj?

Lumturije (Lumka) Krasniqi: Po, në familjen time, në fakt në familjen e dajve të mi, familjen e nanës, ka qenë i vrarë axha i nanës time edhe kështu që ai gjak nuk asht' falë me kohë dhe ka vazhdu me gjenerata, por nuk asht' falë por as nuk asht' marrë. Kështu që, gjatë pajtimeve, gjatë kohës së pajtimeve, këta të familjes, nana jeme [vjen] edhe me thotë që, "Kqyr bre bija jeme masi ti je në qat' Këshill, kqyr mbledhi ata burra diqysh edhe bone. Pajtoj se asht' edhe nji gjak në familjen teme. Mos na le me vragë". Edhe unë shkoj edhe bisedoj me dajën tim, atij, domethënë daja djali axhës që ju kish vra baba. Edhe i thom unë, "Daja Haxhi, unë, ti e din që unë jam në Këshillin e Pajtimit të Gjaqeve edhe jam ardhë me fol me ty që na të dillën dojmë me ardhë me krejt, me profesor Anton Çettën me ata për me na fal gjakun". Edhe ai heziton edhe thotë, "Jo, nuk e fali gjakun se thojnë, unë nji djalë, jom i ligë, unë kështu", i thashë, "Po, ti dajë s'e ki nxirr që sa kohë edhe tash duhet për hir të çështjes kombëtare, për hir të çështjes së Kosovës, për hir të kësaj lëvizje, ti duhesh m'u pajtu, duhesh me fal gjakun", edhe ai hezitoi edhe as që bisedoi për atë punë.

Ndërkohë, djemtë e tij që i kishte ai, katër djem më shtynin mu çdoherë që, "Mos e lë këtë punë, mos e lë këtë punë zhag, mos e lë këtë punë zhag!" Edhe një ditë unë i lajmëroj familjes së tina, i lajmëroj unë Këshillit të Pajtimit që duheni me ardhë të shtunën. Ata edhe e dinin që asht' nji gjak në familjen e

dajve të mi edhe e lamë që një të dille të shkojmë na në pajtim, te familja e dajve të mi për pajtim. Shkum atje edhe ata ishin përgatit, në fakt daja jo, por familja e dajës ishin përgatit për me na prit në atë dhomën e madhe. Sallonin e kishin rregullu bukur, kishin ftu njerëz, kishin ftu të lagjes, kishin ftu se ishte nder i madh për me shku Anton Çetta, me shku Ramiz Kelmendi, me shku Këshilli i Pajtitimit, Mark Krasniqi, Azem Shkreli, Esat Stavileci, Bajram Kelmendi, këta m'i shku në familje, dikujna mi hy [në shtëpi] ishte nder shumë e madhe në atë kohë, ishte nder.

Edhe kur shkum na ishin dalë krejt lagjja, çfarë kënaqësie me pa. Ishin dalë lagjja me kqyr kush janë, po vijnë krushqit e pajtitimit. Kemi shku na, kemi hy, aty ishte edhe baba jem, se unë i thashë edhe babës që, “Shko ti atje edhe rri edhe sido që të jetë na ndihmo pak”. Kur kemi shku atje, kemi hy, ai daja u shtang amo s’kish çka me bo se na i hynëm, shqiptarit kur t’i hyn në shpi s’ki, të hyn në besë. Edhe jemi ulë, kur po i thotë Ramiz Kelmendi, si sot më kujtohet, thotë, “Haxhi Gashi, ti e din për çka ja kemi mësy na”, edhe ai po i thotë, po e ulë kokën, po thotë kshtu, “Po” {pohon me kokë}. Tha, “Kqyr për çka jemi ardhë na?” Tha, “Po ta tregoj një sen. Ti e din me Kanun, me Kanun,” tha, “nipi për dajë qet pushkë,” ai tha, “Po,” tha, “por nipi për dajë” tha, “edhe falë”. Ai po e ulë krytë edhe po i thotë, “Po,” tha, “e në këtë rast ti e fale, s’e fale” tha, “na mbesën tande e kemi me neve, asht’ krushkë e pajtitimit”. Tha, “E na nuk po ta lypim, ti a na e falë gjakun a s’na falë, por na po e lypim gjakun, nëse ti nuk e falë ka me e falë mbesa jote”, ai tha, as nuk hezitoj pak me atë krenari tha, “Jo,” tha, “kjo... unë po ja la mbesës teme gjakun me e falë, kjo me vendos edhe çu fale gjakun”. Masandej, u çova unë edhe e fala gjakun e dajve.

Kështu që, unë anëtarja e Këshillit të Pajtitimit e fala njëkohësisht gjakun e dajve. Kështu që, ish një gëzim shumë i madh, osht' pajtu. E masandej unë me Serbezin, me Flamurin edhe me Rizën kemi shku edhe në Lumbardh e kemi çu fjalën atyne gjakësorëve që je pajtu. Ata as që kishin idenë që ka shku dikush m'i pajtu. Kemi shku na edhe kemi hy edhe kur na kanë pa natën, “Çka ka ndodhë?” Na po i thojmë, “Kshtu, kshtu, kshtu kemi ardhë, na jemi anëtarët e Këshillit të Pajtitimit, kshtu, kshtu, kshtu jemi ardhë me ta kumtua lajmin që gjaku t’u ka falë”. Edhe, mbet, edhe unë thashë, “Unë jom mbesa e Haxhi Gashit, unë jom ardhë ty me ta fal gjakun. Njëkohësisht e kena falë gjakun edhe me Këshill të Pajtitimit, Ramiz Kelmendit, Mark Krasniqin”. U gëzunë shumë. Kështu që, pak a shumë e pash që unë isha një pikë shumë e vogël e asaj lumturie familjare që ishte në krejt familjen e dajve të mi, u gëzunë sigurisht. Ja kështu.

Masandej kemi vazhdu nëpër fshatra, nëpër, nëpër... më kujtohet një rast shumë i... ai asht’ rast shumë i tmerrshëm, atë po du me lidh edhe me babën diqysh se... një nënës diku ka rrethi i Istogut ia kishin vra babën edhe ajo s’dojke me falë, familja po, e ajo s’dojke me falë, tmerr ka qenë rasti. Edhe ajo e kishte emrin [Besa], po tashti ia kish dhonë fjalën, besën babës të vet që unë s’kom me falë gjakun, kom me ta nxirr hakun. Kështu që, të nesërmen shkum na edhe nuk e fali. Edhe kur u ktheva unë në shpi po i thom babës, “Babë,” thashë, “du me të pyet diçka”. Babi tha, “Çka?” I thashë, “Nji, kshtu nji pyetje”, thashë, “për shembull larg qoftë me të pasë vra dikush ty,, thashë, “e ti me më thanë merrma gjakun, unë me të premtu që kom me ta marrë gjakun, e tash m’u kërkua prej popullit e për hir të lëvizjes m’u kërkua me falë gjakun që ta kom premtu ty që e marrë hakun, e me falë çka kishe thanë

ti? A ish dashtë unë me falë, a asht' dashtë premtimin me mbajtë?" Tha, "Kur asht' çështja kombëtare", tha, "kurrë premtim mos mbaj, personal. Premtimet personale thyhen për çështje kombëtare. Gjithçka", tha, "jo veç mu, por krejt familjen me ta vra, a kërkon kombi, a kërkon flamuri", tha, "duhet jo më falë, por duhet edhe jetën me dhanë. Kështu që", tha, "qekjo asht' t' përgjegja jeme, për çështje kombëtare, për flamur".

Kështu që, pak a shumë u preka, mendova pse ajo çika nuk po e falë, kështu që javën tjetër veç ish pajtu ajo, ish pajtu që do ta falë edhe shkum. Masandej, mas dy javëve kemi shku edhe e fali gjakun, por më kujtohet tronditja shpirtënore e asaj vajzës, kurrë s'kom me harru, ajo bisteki i saj, kur hyni në dhomë, më shumë na qanim sesa që qante ajo. Tmerr, tmerr!

Kanë qenë shumë raste, ka pasë plagë, varrë masandej kemi shku edhe me kujtohet me një rast unë e Serbezi edhe Flamuri kemi shku në Dubovë, kemi shku me... e kishin vra një djalë të ri. E kishin pasë vra edhe tash na shkum për me kërku me na përgatit, për me na falë. Çuditërisht ata vllaznit e vet neve na njihshin, unë nuk e dija që na njihshin neve, na ishim të ri, qysh me thonë na nuk i jepshim randësi vetes kush jemi na, s'jemi kurkushi, na veç çka shkojshim, na e konsiderojshim veten si postier në atë kuptimin që shkojshim me bartë, me bind njerëzit, me çu lajme, me ashtu.... Kur shkum na aty në Dubovë edhe ata ishin dy vllazën edhe një motër aty, prindërit nuk qëllun edhe thanë, "E dimë pse jeni ardhë. E dimë kush jeni, kështu që hiç nuk ka nevojë me fol me neve, na po pijmë kafe. A doni çaj?" Kështu, na thamë, "Jo çaj, po e pimë nga një kafe".

Ish shumë vonë atë ditë, atë natë. Tha, "Të dillen tjetër, kur doni, veç na lajmëroni kur vini në sa ora, se gjaku falet. Na kena vendos që kush të na vjen në derë neve për këtë çështje, nëse na vinë këta burrat e mdhaj, na gjakun e vllaut kena me falë". Edhe shumë burrënisht e kanë falë gjakun atë ditë kur kemi shku në Dubovë, më kujtohet si sot, Anton Çetta me neve shumë rrallë ka ardhë në disa, veç kur ka qenë rastet shumë të ronda, por kryesisht në rrethin e Pejës, në grupin e Pejës ka qenë Mark Krasniqi, Esat Stavileci, Azem Shkreli, Ramiz Kelmendi edhe Bajram Kelmendi prej këtyne profesorëve të mdhaj që ishin, por kryenin punë të mdhaja. Kryenin punë burrënisht edhe çfarë nderi ku hynim diku, krenari, por edhe dhimbje, domethanë sa krenar, sa dhembshuri edhe krenari.

Pastaj, më kujtohet, po e ndërldhi se u pajtun shumë gjaqe, kaloi një kohë u pajtun veç shumë gjaqe, shumë plagë, shumë varrë. Edhe na shkonim, u ndamë në grupe masandej, u ndamë në grupe. Po, më kujtohet kur asht' mbajte kuvendi i parë, e mbajtëm mandej na një kuvend. U organizu Kuvendi i Pajtimit të Gjaqeve, Këshillit të Pajtimit të Gjaqeve. U mbajtë në Strellc, më kujtohet si sot. Patëm disa mosmarrëveshje me grupe, se jo të mbahet në Jabllanicë, në Novosellë në xhami apo të mbahet në Strellc. U vendos në familjen e Rizës, vendosi në fakt Ramiz Kelmendi ka qenë kshtu' shumë strikt edhe kur vendoske ai topi s'e lunte. Edhe, vendosi që të mbahet në Strellc në shtëpinë e Nimon Alimusaj, profesorit Nimon Alimusaj që ka qenë një njeri shumë, një aktivist jashtëzakonisht i madh, jo veç i pajtimit të gjaqeve, por i çështjes kombëtare. Edhe aty asht' mbajtë Kuvendi i Parë. Unë e pata... unë si sot më kujtohet, unë isha ajo e cila e mbajsha...

Rexhep Myftari: Proces verbalin?

Lumturije (Lumka) Krasniqi: Eh po, më fal, proces verbalin, se po më përzihet më anglisht e më shqip e me serbisht (qesh), edhe proces verbalin dhe kështu që e pata mbajtur unë atë ditë. Më kujtohet si sot, deri atë ditë ishin pajtu 800 gjaqe, kjo më kujtohet 800 gjaqe deri atë ditë. Ditën e Kuvendit u patën pajtu 800 gjaqe dhe fshati Strellc e kishte organizu, e kishte organizu aq mirë atë farë sigurinë e kuvendit, shtëpisë. Kur kemi shku na s'kemi mujtë, s'kemi ditë ka me hy, krejt me traktora e rrethume ajo shpija, krejt e barrikadume gjithçka. Kështu që, mbasi u kry, se msheftas u kry shumë shpejtë. Pasi jemi kthi na, policia veç kishte shku në shpinë e Nimon Alimusës dhe kishte bo domethanë... thujem shqip bre (qesh)... kështu që... nale pak...

Rexhep Myftari: Mandej muna me vazhu nëse na tregon edhe për rastin që ka ndodh te shtëpia e profesorit, si rezultat i asaj që ju keni qenë të angazhume, e ai ka qenë i involvum.

Lumturije (Lumka) Krasniqi: Aty kurgjo, veç...

Rexhep Myftari: Si e kujton ti?

Lumturije (Lumka) Krasniqi: Unë... mbasi jemi dalë na, mbasi jemi dalë na, jemi dalë shumë të sigurtë, jemi kthi, jemi shku secili nëpër shpija të veta, ka qenë e dille edhe atë ditë. E mbasi jemi kthi na, mbasandej policia ka marrë vesh. Por, policia kishte qenë gabimisht i informum që Kuvendi i Pajtimeve të Gjaqeve do të mbahet në Novosellë, në xhaminë e Novosellës dhe kur kanë shku ata atje, fatmirësisht s'ka pasë kurgjo, asnji kuvend, asnjigjo. Kështu që, ma vonë janë informu, ata informatorët e asaj kohe, ka pasë gjithmonë edhe janë informu që po mbahet në Strellc asht' t'u u mbajtur, por na fatmirësisht e kishim kry kuvendin edhe jemi kthi nëpër shpija. Atëherë, kishin shku aty, kishin, kanë hy, kanë kërk, kanë demolu shpinë, e kanë... nuk e di a e kanë arrestu dikond, për atë kohë s'e di nuk mbaj mend.

Kështu që, por e di që profesori të nesërmen na tregoi që, "Nuk ki çka sheh në shpinë teme, por nuk kanë gjetë asnjigjo". Edhe ka thanë që, "Kurgjo. Kanë ardhë burrat, unë i kom thirrë në drekë, darkë kshu drekë kanë ardhë, kemi ndejtë na qysh mbahen nëpër oda, nëpër fshatra". Kështu që, po më duket pa pasoja, pa pasoja familjare ka kalu profesori. Dhe kështu, vazhdon ai kalvari i pajtimtarëve deri në maj, kur edhe u mbajt, kur u mbajt edhe Kuvendi i Pajtimeve të Gjaqeve në te Verrat e Llukës. Ajo asht' diçka që sigurisht secili shqiptar, secili nuk veçoj që ka qenë në atë kohë i vetëdijshëm, që ka qenë në moshë për me kuptu diçka, ka qenë ajo ditë, ka qenë kujtimi i ma i mirë i krejt atyre gjeneratave. Nji mobilizim...

Rexhep Myftari: Qysh ka ardhë deri te... ?

Lumturije (Lumka) Krasniqi: Pajtimi?

Rexhep Myftari: Para se me ardhë te pajtimi, dita e madhe te Verrat e Llukës?

Lumturije (Lumka) Krasniqi: Po, na, kur filloi faza e parë e pajtimit të gjaqeve, kish pajtime sot në nji

fshat, nesër në një fshat, filluan tani në masa ma t'ndhaja, njerëzit u formun në grupe të mëdha, grupe të ndryshme të pajtimtarëve se nuk kish mundësi për shembull një grup, një Anton Çettës, një profesor Mark Krasniqit, një... me shku në të gjitha ato pajtime. Kështu që, u formun grupe të ndryshme në krahina të ndryshme të Kosovës dhe ndërkohë u ba e pamundshme që atëherë me u pajtu, me shku çdo ditë me ba pajtime edhe u vendos që me një ditë të organizohet një kuvend se... në një kuvend të falen të gjitha gjaqet përnjëherë. Kush donë me falë gjaqe edhe aty le të vjen edhe të falë. Kështu që, u vendos të mbahet te Verrat e Llukës për shkak se ajo datë edhe ai vend ka qenë si simbol i pajtimit në kohën e... në kohën e Haxhi Zekës, kohën kur ka pajtu Haxhi Zeka me grupin e vet, grupin kur ka qenë Lidhja e Pejës. Në atë kohë kanë pajtu gjaqe edhe te Verrat e Llukës janë ba pajtimet, domethanë pajtimet e tilla, jo ashtu në përmasa të mdhaja, por asht' si simbol i pajtimeve të gjaqeve Verrat e Llukës me 1 maj.

Kështu që, vendosem si simbol ta bojmë edhe ta organizojmë, jo unë, por e kishin vendos atë këshillin domethënë organizatorët që ishin grupi i organizatoreve ndër ta ishte edhe Flamuri i cili neve për secilin gjë, për secilën informatë, secilin veprim, na ishim të informum krejt prej Flamurit, Rizës edhe kryesisht profesor Ramiz Kelmendit. Edhe e organizum paraprakisht shkum na një ditë, dy përpara, i organizum njerëzit, organizum ato, vendin. Sali Cacaj ishte një ndër organizatorët që e... skenarin, ai ishte i ngarkum për këto lloj gjanash edhe u mblodhëm. Çuditërisht, çuditërisht unë nuk e di qysh kanë marrë vesh njerëzit, nuk e di krejt Kosova që çohet po më duket që osht' tepër me thanë, e ekzagjeroj 1 milion, por së paku 500 mijë vetë thuhet, thuhet që minimumi kanë qenë atë ditë. Kemi shku, por aty dihet, qaty shihet një solidarizim i popullit jashtëzakonisht i madh, as në luftë as nuk e di çfarë solidarizimi kishte me u bo për ndonjë çështje tjetër.

Më kujtohet si sot atë ditë unë s'kisha makinën time, e kishte Serbezi makinën edhe mu erdhi më murrë me makinë, se u ndamë në grupe, edhe më murrë me makinë mu Esat Stavileci, Azem Shkreli edhe Bajram Kelmendi. Këta erdhën më murrën mu në Pejë, kështu që ishim me një grup, shkum na për me shku deri te Verrat e Llukës. Zo, sa bukuri, bukuri me thanë kështu. Rrugës delshin njerëzit, kishin organizu fshatarët më vetiniciativë, kishin qit' flija, kishin bo bukë, kishin bo petlla, kishin bo... kishin marrë ujë, kishin marrë paramendoje edhe limonada me ato farë xhygmat e tyne rrugës. Ti s'kishe qare, ti kalojshe edhe nuk u ndalshe me marrë një copë pite, një copë fli, veç i fyejshe ata se jo që... i nderojshe m'u ndal edhe me marrë një copë. Domethanë, organizim... gratë ishin vesh bukur me veshje kombëtare rrugës, krejt derë em derë, prej Pejës e deri te Verrat e Llukës, lagjeve, fshatrave ti ke pa bukuri, aty e ke ditë që na jemi të bashkumë, pak a shumë jemi bashku. Jemi bashku, jo shumë, por pajtimi i gjaqeve në atë kohë i bashkoi shqiptarët në Kosovë saqë aq shumë sa asnjigja tjetër ma shumë s'ka mujtë m'i bashku, s'e di çfarë fenomeni tjetër kishte m'i bashku shqiptarët në atë kohë.

Pastaj, kur shkum atje fillun njerëzit, ata çka ishin veç në listë që kishin m'u falë me dalë paraprakisht në skenë, aty në binë për me e falë gjakun. Atëherë veç fillun njerëzit falshin edhe vet, ata që ishin në gjak që nuk e kishin falë deri në atë kohë, ata delshin në skenë vet. Edhe qaq u ba ajo radha e madhe, sa se pritke njeri-njerin për me dalë me e falë gjakun Anton Çettës. U falën atë ditë, u falën gati s'e di

nja 60-70 s'e di sa raste, u patën falë shumë gjaqe, 66-të a s'e di. U patën falë shumë gjaqe, po masandej pat' pasoja ajo. Kur u shpërndamë neve, krejt ata pajtimtarët, njerëzit që ishin ardhë, shpërndamja ke pak me pasoja, por prapë së prapë ato harrohen, ato pasoja, ato kërcënime prej pushtetit, prej policisë, prej... ato u kalun. Ne ia arritëm qëllimit, u pajtun gjaqet pa ndonjë incident, populli u kthy, secili u kthy nëpër vende, shpija të veta, dhe sot e asaj dite morri jehonë shumë të madhe. Edhe njerëzit masandej edhe sikur u solidarizuan në mes vete ma shumë, u vllaznunë në atë kohë, u vllaznunë, u lidhën në mes veti. U lidhën aq tepër saqë ndihma, ndihmojshim njoni-tjetrin financiarisht, moralisht, gjithsesi.

Rexhep Myftari: A mundesh me i nda me neve disa kujtime të veçanta që i kë pasë [me] bashkëpunëtorët tu ma të afërt edhe me njerëzit që realisht bashkë i keni udhëheq pajtimin e gjaqeve?

Lumturije (Lumka) Krasniqi: Më kujtohet me një rast, për shembull po e veçoj një pajtim, ishim në një fshat diku në rrethin e Pejës më duket që ka qenë edhe ajo në rrethin e Iligjes diku. Edhe shkum neve, shkum me... kemi shku me përgatit gjatë javës, ata nuk e falnin gjakun edhe na vendosem që me shku një të dille me i hy në shpi ashtu qysh shkojshim t'dille për t'dille edhe me kërkun që me na falë gjakun. Kur hynëm aty, ai i zoti i shpisë, domethënë baba i të vrrarit, ai su pajtojke kurqysh, "Unë kom me marrë gjakun", e kështu tha. Më kujtohet Azem Shkrelit ka pasë fjalë shumë të forta dhe shumë me vend edhe ulet edhe i thotë, "Po bre burrë, ti e kishe marrë gjakun, po me pasë një pushkë të gatë prej ktuhit e atje e kishe vra". Domethënë, që s'e ki vra deri tashti, e tashti po donë m'i shti thmitë e tu m'i vra. Tha, "Me pasë një pushkë të gatë prej ktuhit e me vra atje, e kishe vra", tha, "por, nuk e vranë ti". Tha, "Po çohu bonu burrë," tha, "qetash edhe fale gjakun". Tha, "Jo gjakësorit, jo atij, po falna neve, por jo neve, po falja qesaj rinisë getu, rinisë së Kosovës, për të ardhmen e Kosovës, për të ardhmen e fëmive të tu, për të ardhmen e krejt kombit shqiptar".

Edhe ai ndejti, ai njeri ndejti edhe e pa veten që... e pa sigurisht që me atë pushkën e gjatë të Azem Shkrelit edhe me atë pushkë s'kishe mujt me vra, u çu edhe hezituj, hezituj edhe i tha, "Paj bre burrë s'po di çka me ju thanë, po falë ju koftë". Edhe u çu edhe kajti pak, e a din ,ai momenti më kujtohet veç pushka e Azem Shkrelit, ajo pushka e Azem Shkrelit, pushka e gjatë e Azem Shkrelit më kujtohet shumë si... e kom kujtim të freskët edhe ndikoj që me falë gjakun. Ka shumë raste, po, që kemi shku, por me të vërtetë ato rastet mbesin kujtim. I kujton kohë mbas kohe, momente mas momenteve.

Por këta profesorat, bashkëpunëtorët, domethënë bashkëpunëtorët, ata s'kanë qenë bashkëpunëtorët e mi, ata kanë qenë njerëzit të cilët e kanë pajtu e kanë udhëheq atë kalvarin e pajtimeve. Se sikur të mos kishin qenë ata beso që pajtimet do të ishin ma të vështirsime, por kanë qenë burra të mdhaj që asht' shumë mëkat, për shembull Anton Çettës që sot e kësaj dite nuk u kujtu hale kush që ta kujtoj më një lapidar, a me një... edhe kom dëgju që kërkesat jonë bo për me ja kushtu me një farë lapidari, por sikur kanë hezitu. Esat Stavileci ka qenë një, besoni që i ka pasë fjalë, shumë fjalë me vend, një profesor shumë i qytetërum, ka ditë me ato... na qysh thojmë se Anton Çetta, Mark Krasniqi e këta nganjëherë folnin me mesele, me mesele të odave, me mesele të fshatarëve, me

mesele që e kërkonte vendi. Mirëpo, Esat Stavileci kur fliste ai, ai në mënyre shumë të qytetërume ndikojke që vrasja me u falë.

Rexhep Myftari: Te Verrat e Llukës qysh e kujton ti ditën? A mundesh me na përshkru, na folëm qysh deri t’u shku atje rrugës kanë dalë gra e burra e thmi e të rritun e ju kanë përcjellë, ju kanë prit, ju kanë jep ushqim, e kur keni shku atje qysh të kujtohen njerëzit? A ka qenë me shoke... ?

Lumturije (Lumka) Krasniqi: Kshtu, përshtypja ma e madhe që më kujtohet, që më ka lanë edhe që më kujtohet fotografia e asaj dite, më kujtohet njerëzit në plisa të bardha, domethanë njerëzit që kishin ardhë kryesisht ish bardh. Domethanë, me plisa ish mbush pajtimi, edhe ata që ishin fshatarë, edhe ata që mbanin plisa, por shumica e njerëzve kishin vnu’ plisa. Domethanë, u shihke aty veç krenari, bardh, krenari. Më kujtohet edhe Anton Çetta ishte në binë aty. Unë isha me... unë, Flamuri, Serbezi, kurrë të pandamë, ishim në tokë të ulun, kambë kryq si sot, Sali Cacaj ishte ai që fotografonte, organizonte. Masandej, më kujtohet një gru, më kujtohet një rast aty kur një gru u çu me falë gjakun e burrit. Ajo m’la përshtypje shumë mu, se te shqiptarët gjaku falet, nuk falet gjaku i burrit por falet ja gjaku i djalit, vllaut, axhës, domethanë gruja për burrë nuk falë gjak.

Mirëpo, atë ditë aq na la përshtypje qajo falja e gjakut që e fali për burrë, pse? Sepse ajo fëmijtë i kishte të vegjël. Masandej na e murrëm vesh sepse i kish fëmijtë e vegjël, shumë të vegjël, ja kishin vra burrin, ata kunetërit e vet nuk dojshin me falë gjakun edhe kjo dul publikisht edhe e fali para gjithë këtij, para gjithë popullit të Kosovës, para kësaj rinisë, ja fali gjakun, ajo ashtu i tha Anton Çettës, tha, “E fali gjakun e burrit”. Pak njerëzve ju duk pak si ma e folklorizume. Mirëpo, ish gjak shumë i sinqertë edhe që domethënë ajo falje e gjakut ndikoi që fëmijtë e vet, fëmive të vet të ua hekë një plagë të jetës. Domethënë, edhe një barrë, t’i liroj fëmijtë nga një barrë e hakmarrjes edhe ishte gjest shumë i mirë. Unë për veti do ta bëja edhe unë. Thojshin, “Pse burrit?” Thojsha, “Edhe unë e kisha bo. Me ma vra burrin dikush, s’pe falë dikush gjakun, fëmijtë i kom të vegjël, po ma kërkon kombi, e fali. Pse nuk e fali?” Kështu që, ajo m’ka lanë përshtypje shumë të madhe si falje e gjakut te ajo ditë edhe ajo fotografia, fotografia e njerëzve që ishin mbledhë aty nuk shihej tjetër gja, pos bardh domethanë me plisa të bardhë.

Edhe, sigurisht që më kujtohet ato kur ishin, më kujtohet tanksat e policisë që ishin të rrethum, mirëpo as që... ishim të rrethum, i shihshim, por nuk i vërejshim. Domethanë, nuk na lejshin përshtypje se ishte t’u ndodhë diçka ma e madhe, nuk na lente përshtypje çka janë ata, na p’e kryjmë ni mision tonin, p’e kryjmë ni mision shumë të madh, policia e kryn punën e vet, që ndodhë diçka na veç e kryjmë. Por, ndodhi nifar kacafytje pak, i arrestun disa edhe më kujtohet ajo trimnia e atij profesor Zekeria Canës, ajo asht’ jashtëzakonisht diçka që s’e harron kurrkush. Kushdo që e ka pa, edhe e kanë pa t’gjithë më duket, shumica ça kanë qenë aty afër e kanë pa atë trimninë e Zekeria Canës kur i del tenkit të policisë edhe i thotë, se ata dojnë me hy, edhe ky i thotë, “Qitni, qitni”. Edhe e çelë si Mic Sokoli. Na masandej e thirrshim edhe Mic Sokol.

Ai ka qenë shumë trim edhe euforik në momente edhe e ka gjetë momentin edhe s’ka kqyrë, e ka çelë, “O gjuni”, edhe serbisht ashtu p’i thotë. E masandej, ata policia e panë që me bo me gjujt masa e

madhe e eskalon situata, kështu që i hynën e prapë u kthyn edhe u futën nëpër vendet e veta edhe na kalum. E patën arrestu masandej Zekeria Canën atë ditë, po e kanë lshu në të njëjtën ditë e kanë lshu. Masandej, na mbasi u kry pajtimi i gjaqeve... e kjo osht' e mira, mbas pajtimit të gjaqeve, u kry, na edhe shkum. Besoni vishin fshatarët, se na ishim afër, na ishim Këshilli i Pajtimit, ça ishim, ishim afër ulun në rreth tonin rend aty para, në tokë ishim të ulun. Edhe erdhën fshatarët, vishin edhe na merrshin për drekë, prej atyhit tanshi me shku nëpër dreka, nëpër oda, e jo pse dreka, po, me ardhë me na nderu odat, e me hy. Kështu që, profesorat u ndanë shkoj dikush një odë, dikush një odë me prit.

Na qëllum me një odë aty, bile e kom një fotografi unë, Serbezi edhe profesor Azem Shkreli. Aty mbas Verave të Llukës u ndalëm me një fshat, me një familje që ish edhe ai... edhe ai kish kontribu në pajtimin e gjaqeve po me çdo kusht na ftoi që të shkojmë në drekë në familjen e tij, shkum edhe ai më kujtohet ai rast shumë, ato... domethënë bujaria e shqiptareve u tregu atë ditë shumë e madhe, në fakt mas parti bujaria sepse u pajtun gjaqe, shumë gjaqe, falën njerëzit gjaqe, trimni, trimërisht kanë falë gjaqe atë ditë. Edhe bujaria edhe ajo madhështia e njerëzve që kanë ardhë prej krejt Kosovës, kanë ardhë për me marrë pjesë në pajtim të gjaqeve, domethënë për me marrë pjesë në atë pajtim te Verrat e Llukës, që ishte diçka fenomenale, murrë jehonë shumë të madhe ajo. Kështu që, ndikoi të vetëdijësohemi pak ma shumë kombëtarisht edhe sigurisht që u vedijësum.

E nga ajo ditë e të mbas pajtimi i gjaqeve filloi pak si me u ngadalësu se u pajtun gjaqet përnjëherë edhe fillun atëherë mu ngadalësu pajtimet, aty këtu nga një, profesorat veç u shpërndanë. Mirëpo, ka vazhdu, disa kanë vazhdu. Kem vazhdu ndoshta deri kah shtatori edhe ma vonë aty-këtu kanë shku grupe të ndryshme.

Rexhep Myftari: A mundesh me na tregu për ndonjë ngjarje që e kujton e që mundet mu cilësu si diçka ose qesharake ose që në ato momente të vështira ju ka bo juve mu ndi pak ma ndryshe?

Lumka Krasniqi: Po ka raste. E kisha veçu një për shembull që kshtu ka qenë pak si ma relaksuese në atë si tension ka qenë, tension ato tensione kanë qenë ato në ato momente kur falej gjaku ashtu. Më kujtohet një rast ishim në rrethin e Klinës dikun në njërin nga fshatrat e Klinës edhe unë përndryshe kom punu në Klinë në atë kohë. Punojsha në një organizatë tregtare edhe kur shkum atë ditë i pajtum gjaqet, u pajtu ai gjaku dhe kur në momentin kur dulëm, u pajtu edhe dulëm, ai zoti i shpisë ju kthy, ju drejtu Azem Shkrelit edhe p'i thotë, "Profesor," p'i thotë, "a gjakun ju falëm tash ju keni me na falë qet' çikë," tha, "edhe na nuk p'e lojmë ketë çikë hiç me shku sot, po veç ju shkoni". Ai po i thotë, Azemi profesori p'i thotë, "E valla jo," tha, "kemi shumë çika, cilën t'doni po ua jepim veç qeto jo, se qeto e kemi ma të mirën," tha, "edhe kto e kena për veti". Kështu që, filloi ajo punë si hajgare, po e kishin pasë seriozisht, e kishin pasë seriozisht se i kishin pasë... atë punë e kishin pasë rreh [diskutu] që i thojmë na nëpër oda, e kanë rreh atë punë, këtë punën teme. Edhe kështu që, sa herë shkojshim dikun tjetër thojke profesori, "Po tutëm tash mos po na lypin ktu naj çikë more, cilën çikë a thu e ka renin me na lyp?" Kish edhe momente kshtu, momente pak humor bojshim, momente për m'u relaksu edhe në këto falje të gjaqeve në momente ma të vshtira.

Rexhep Myftari: A mundesh me na tregu tash pajtimi i gjaqeve veç filloi me u zvogëlu numri... ?

Lumturije (Lumka) Krasniqi: Po aktiviteti pak filloi me u ngadalësu edhe vet filloi... edhe pastaj çka the?

Rexhep Myftari: Po me na tregu tash prej kësaj fazës kur e keni përfundu pajtimin e gjaqeve, qysh vazhdon aktiviteti juj në çështjen kombëtare?

Lumka Krasniqi: Po, mbas pajtimeve të gjaqeve në vitet '90-'91, atëherë aktiviteti im veç ka vazhdu, nuk asht' që jam ndal për asnji moment, atëherë veç çka asht' vazhdu aktiviteti edhe ma shumë. Fillum atëherë në shoqatën, organizatën "Nënë Tereza", aty u angazhova tepër. U themelu organizata, shoqata jo organizata, shoqata "Nënë Tereza". Ndërkohë, atëherë rinia e Pejës, na nuk ishim... fillun m'u themelu disa parti, domethanë Partia Republikane, Partia Demokristiane, Shqiptare Demokristiane, pastaj Partia Liberale, jo Parlamentare. U formun disa parti, mirëpo na në Pejë ishim, qaq ish rinia që ishim disa aktivista që në çdo kohë qysh në '89 e deri në fillim të luftës kemi qenë gjithmonë së bashku të pandamë, kemi vepru bashkë një grup i... një grup goxha i madh, po i veçum.

Edhe kem fillu mbasandej aktivitetin në '91-tën, më kujtohet jo... du m'i veçu kta aktivitetin tim edhe në, kur ishin helmimet e nxansve në po atë vit, në pranverë ish helmimi i nxansve nëpër shkolla të mesme. Edhe, unë isha shumë aktive në atë kohë sepse isha në punë ndërkohë, në fakt isha në punë në Klinë kur ndodhi kjo edhe po vjen Serbezi edhe po m'tregon, "Kshtu, kshtu, kshtu, ka ndodhë". Kështu që, ajo e kish makinën edhe unë kisha të njoftun në spital, më punojshin jo çikat e tezës, çikat e hallës e shoqe, kishim shoqni e të njoftun në spital në Pejë. Kështu që, na u angazhum shumë me doktor Mustafë Ademaj, ai ishte edhe ai ish njeri nga ata që kishte marrë pjesë në pajtimin e gjaqeve dhe ishim të lidhun na, ishim të lidhun ngushtë. Pastaj me doktor Mustafën edhe ndihmum shumë për bartjen e të helmumve nga... nëpër shkolla, nga spitali i Pejës i transferum në spitalin e Prishtinës me makinën e Serbezit, me kujtohet si sot. Dy i patëm çu në Prishtinë, unë e ajo edhe të tjerët tona veç kemi ndihmu kshtu nëpër shpija kemi çu barna.

E masandej, ndërkohë për mu aktiviteti, për mu aktiviteti pak si u ndal në një kohë në vitin '91, ndodhi një tragjedi për mu shumë shpirtnisht, ndodhi. Serbeze Vokshi vdiq tragjikisht dhe nga ajo disi u pasivizova për nja dy vjet. U pasivizova se u dëshpërova keq. Kështu që, fillova edhe u morra ma shumë me profesion në atë kohë. E hapa një biznes temin, fillova pak ma shumë me ja përkushtu domethanë profesionit, mbajsha kontabilitete firmave, kshtu një biznes të vogël. Edhe masandej në vitin kur filloi viti kur ishte ajo kah fundi i viteve të '90-ta atëherë... jo fundi, mesi i viteve të '90-ta unë në ndërkohë erdha, u formu, erdha, m'u paraqit rasti me ardhë në Amerikë. Jo m'u paraqit rasti po erdha për një kualifikim domethanë studim profesional në Oklahoma të Amerikës edhe qëndrova për, qëndrova për një kohë të shkurtë noshta gjashtë, shtatë muj edhe u ktheva.

Ndërkohë krijova marrëdhanye të mira me atë institutin ku unë isha në Universitetin e Oklahomës, Oklahoma University, kështu që ndërkohë e hapa një degë të institutit në Pejë, në atë kohë në vitin '96-të. Edhe kështu që e hapa shkollën, e hapa pastaj shkollën e gazetarisë në kuadër, shkollën e

komputerëve me bashkëpunim me Riza Krasniqin dhe aty filloi pastaj... Shkolla ku e hapa unë, ndërtesa e shkollës aty filloi atëherë edhe aktiviteti im kombëtar domethanë politik në atë kohë, filloi edhe të shpejtohej pak ma shumë edhe u zgjanu.

Më kujtohet si sot organizata, Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës, zyret, unë ia lëshova me një zyre, u mbajtë aktiviteti, çdo aktivitet i Lidhjes së Shkrimtarëve në atë kohë që ishin të... nuk ishin nëpër lokale, s'kishin lokale, zyre, mbanin çdo aktivitet, çdo takim, çdo... mbanin në shkollën time. Kështu që, edhe unë... aty filloi. Edhe pastaj, në ndërkohë fillova të punoj edhe në "Kohën Ditore", gazeta u hap, gazeta e parë "Koha Ditore" dhe ndërkohë ajo ishte edhe një shtytje që unë... mundësi jo në fakt, mundësi, ishte një mundësi që unë të jem ma afër ngjarjeve, ngjarjeve çka po ndodhë në Kosovë, domethanë ngjarje vendore, politike, ndodhive, informacioneve. Kështu që, njëkohësisht unë merresha, shkruaja për gazetën, njëkohësisht mbledhsha informacione tjera se çka po ndodhë në Kosovë.

Veçse kishin fillu ato fazat e para të organizimit të, jo ushtarak, por organizimit të njerëzve për mbrojtjen e siç e quajtshim atëherë mbrojtjen e pragjeve të shtëpisë në vitin '96-'97, kur u vra edhe Adrian Krasniqi, pastaj veç ajo filloi aktiviteti. Ndërkohë në vitin 1996, kah fundi i vitit '96-tës, na me një grup, po ai grupi i rinisë që ishim i Pejës, t'u e pa se kemi nevojë për një vend, një institucion kulturor, për rini ku na duhet m'u mbledhë, po, të mbledhem, diçka të angazhohem edhe të kontribuojmë diçka, jo vetëm për politikisht, por edhe për kulturë të qytetit, kulturë të Pejës.

Rexhep Myftari: Na trego për themelimin e Qendrës Kulturore edhe për vazhdimin e aktiviteteve tuaja?

Lumka Krasniqi: Po, siç thamë ma herët ne kishim nevojë për një vend ku të organizoheshim, ku të mbledheshim, jo veç na aktivistët, por edhe krejt rinia qytetare, vlerat kulturore t'i thukim në një vend, t'i bashkojmë. Dhe kështu që, në Pejë ekzistonte hamami që ishte një institucion i vjetër sikur banjo publike në atë kohë, që ishte ndërtu qysh në kohat e turqve, edhe u vendosëm na. Ajo ishte shumë... ishte shkatrru, ishte e papërdorun. Kështu që, na kërkum prej Bashkësisë Islame lejen për renovimin e hamamit. Ata nuk hezitun dhe na dhanë. Mandej, kur e murrëm na lejen prej Bashkësisë Islame fillim atëherë të marrim fonde, të kërkojmë fonde prej institucioneve të ndryshme private, prej bizneseve, fondeve vetanake, fonde prej qytetarëve besa, prej "Çarshisë së gatë", që ishin zejtarët, zejtarët e qytetit të Pejës që ishin shumë, shumë të gatshëm për me na dhanë ndihma me kontribu, për me na ndihmu që ta rinovojmë hamamin.

Kaloi një kohë goxha, e renovum, e pastrum dhe u bo një punë shumë e mirë. Dhe ndërkohë vendosëm që aty ta quajmë, ta quajmë Qendra Kulturore e Pejës, e rinisë së Pejës, në fakt u quajt, Qendra Kulturore. Aty organizoheshin mbledhjet, takime. Ndërkohë, unë e barta edhe shkollën time meqë atje ku e kisha unë shkollën time në atë institucion, në atë ndërtesën, ishte si shpi private, ishim të... policia veç pat' fillu që të na përndjek, sepse u mbajshin aktivitete të ndryshme aty. U bartëm, shkollën time e bartëm në Qendrën Kulturore në një pjesë, në një kthinë. Aty mbajshin mësimin nxansat, kryesisht ata nxansat e fillores, domethanë ata që msonin gjuhën angleze dhe që mësojshin

këtë kursin për kompjutera.

Ndërkohë, mbasi u kry krejt ai renovimi dhe u ba renovimi i hamamit vendosëm që, vendosëm që ta organizojmë, kjo ishte në vitin 1998 pra po kaloj derisa u rindërtu, vendosëm që ta mbajmë “Ditët e kulturës Pejane”. Këtë vendim, meqenëse vendosëm, ishin kryesisht 15 ditë që i kishim caktu 15 mbramje, për çdo mbramje ja kishim caktu artistave të Pejës, domethënë secili e kishte mramjen e vet. Nji natë e kish për shembull “Shkolla e ulët e muzikës”, nji natë e kish Shahindere Berljajlli, nji natë ishte e piktorëve, nji natë ishte e poetëve, nji natë ishte e fëmive, nji natë ishte... secili e kishim caktu. Domethanë, për 15 natë të ndryshme kishim ekspozita të ndryshme, i kishim hapë galeri të ndryshme.

Kështu që vazhdoi kjo punë për disa... ndoshta jo plot një javë, filloi në secilën mramje. Natën, më kujtohet natën e fundit kur u ndërpre ky aktivitet domethanë kjo që e kishim mbajtur si festival në atë kuptimin e ngushtë, ishte 5 marsi, nata e 5 marsit, 1998-tës edhe e kishim atë natë, e kishte radhën Sebahate Berljajlli dhe këngëtarët e Përparimit të Pejës, në atë kohë për të këndu. Fatkeqësisht atë natë ndodhi tragjedia në Prekaz edhe u vranë Jasharajt, kështu që ne e ndërpreme atë natë e tutje, e ndërpreme kto’ aktivitetet tjera kulturore dhe vendosëm që të punojmë në heshtje atë çka ishim t’u e vazhdu.

Kto, kto vrasje na ndikun që në Kosovë të bahen, të organizohen demonstrata gati çdo ditë. Në çdo qytet të Kosovës organizoheshin demonstrata në muajin mars. Më kujtohet pastaj me 18 mars ishte radha e organizimit të demonstratës të madhe, domethanë demonstrata ishte kundër vrasjeve... kundër vrasjeve dhe gjenocidit ndaj shqiptarëve që i bonte atëherë shteti serb, pushteti serb. Kështu që, me datën 18 mars ish radha e qytetit në Pejë që të organizonte demonstrata dhe vetvetiu u bo ftesa, as nuk e dishim na as vet kush e boni atë ftesë, ne jse veç populli organizohej edhe dulëm secili dulëm në... Më duket që të gjithë qytetarët e Pejës atë ditë kanë dalë, fshatarët nga fshatrat, nga qyteti edhe ishte nji demonstratë jashtëzakonisht e madhe, por e qetë, ashtu demonstratë e qetë.

Më kujtohet ishim, për shembull janë aty në Pejë, janë tri lagje kryesore, osht’ nji lagje “Ramiz Sadiku” që osht’ lagje shumë e madhe, masandej osht’ lagjja te “Kulla e Pashës” teposhtë që asht’ edhe tjetra që janë tri radhazi, osht’ edhe ajo rruga e “Çarshisë së gatë”. Domethanë, trijat janë me radhë kshtu, e kanë, të gjitha e kanë një dalje të përnjëhershme ku të çon te sheshi i tashëm, sheshi pranë shtëpisë së mallrave. U organizu demonstrata, por njerëzit ishin mbledhë, njerëzit ishin mbledhë aty kshtu {tregon me dorë}, s’dishin edhe kush me i pri se e kishin organizu, por s’kish prirës. Unë, Reshati, Angjelina vendosëm që të shpërndahemi. Unë të rri në rrugën “Ramiz Sadiku”, Reshati të shkon në rrugën e “Kullës së Pashës” dhe Angjelina Krasniqi domethanë shoqja jeme, ajo me shku te rruga e “Çarshisë së gatë”. Edhe e kurdisëm orën që mrenda dhetë minutave, si të bohen dhetë minuta edhe me fillu me marshimin. Marshimin kshtu që të takohemi te sheshi, aty te shtëpia e mallrave e ta bojmë nji kolonë edhe të vazhdojmë marshimin drejt qytetit korzës edhe të bashkohen mandej qytetarët me neve.

Atë ditë ashtu kemi vepru edhe unë, kur ora u bo, u kurdis ora taman e saktë, vazhdum dhe u takum

aty dhe e formum vetëm një kolonë të madhe edhe na kështu që e primë. Unë, Angjelina dhe Reshati rrishim anash edhe e prijshim protestën. Ajo ka, ajo ka ndiku që policia pastaj na ka fotografu, edhe ka ndiku në përndjekjen tonë. Janë ardhë me më arrestu ndërkohë mbas disa ditëve, jonë ardhë me më arrestu te shpija, unë s'kom qellu edhe nuk jom dorëzu kurrë domethanë. Aty e asaj dite nuk kanë mujtë që me na... as mu, as Angjelinën, as Reshatin ose ata edhe hoqën dorë, hoqën dorë edhe nuk erdhën me na kërku mo.

Por, kur u bo mbasandej mbas nja, mbas disa... e tash të ndërlidhëm ktu me atë datë. Atë ditë në qat' protestë, na marshuam nëpër qytet edhe ndërkohë në qat' ditë u vra, u banë disa vrasje. Por, jo në shesh ku ishim neve, po u banë disa vrasje te lagjja e "Fidanishtës" edhe te lagja e... i thojmë na të fabrika e birrës, tash qysh thirret ajo lagja, se di qysh thirret tash po lagja te sheqerhanja. U vranë aty, kur kanë dashtë demonstruesit të bashkohen, të vijnë në qytet, kanë qenë të pengum prej policisë dhe kanë fillu vrasjet. E di që shumë janë plagosë dhe një asht' vra atë ditë, më kujtohet si sot Qerim Muriqi. Kështu që, kjo ka ndiku... ne u mbledhëm pastaj pasi përfundoi kjo, unë, Angjelina, Reshati, Aferdita Kastrati shkumë te vendi ku ishte... ku u mbledhën të gjitha partitë, Këshilli Financimit, krejt u mbledhëm na aktivistat te Qendra Zejtare edhe të bisedojmë se çka ka ndodhë, domethënë bisedonim çfarë ndodhi e tek.

Aty vendosëm që ta formojmë Këshillin për Emergjencë, dhe vendosem domethanë me datën 18 mars, [1998] u vendos që e formum Këshillin për Emergjencë, domethanë që të jepnim ndihma popullit, të bashkohemi se sot u bo një protestë, populli ke pa kurrfarë bashkimi, kurrfarë organizimi, asnjë udhëheqje, dikush duhet diçka të veprojë, kështu që e formum Këshillin për Emergjencë. Atëherë, e bartëm qendrën, selinë e Këshillit të Emergjencës dhe e vendosëm që ta mbajmë edhe ta vendosim në shkollën time apo përndryshe në Qendrën Kulturore, po jo në pjesën ku ishte ato pjesët e galerisë e ato pjesët ma historike që ishin ndërtu, po në këtë pjesën që ishte ma, pjesën ma oficiele që ishin, zyret i kishim organizu aty.

Pjesa e Tretë

Kështu që vendosëm atë ditë meqë u paraqit nevoja të themelohet një, një diçka, një shoqatë, një këshill apo diçka që t'i ndihmojmë popullit ose qytetarëve të Pejës, na mendonim në atë kohë vetëm çka sa i përket qytetarëve të Pejës. Kështu që, vendosëm edhe e themeluam Këshillin e Emergjencës, kështu që vendosëm kryetar që ta zgjedhim, ka qenë shumë i dashur për popullin e për qytetaret e Pejës, një aktivist, një patriot shumë i madh Rashit Gorani. Atë e zgjedhëm për kryetar. Neve ishim, u ndamë në grupe, unë me grup isha me Angjelinën edhe Angjelinën, Aferdita Kastratin, Mentor Morina, Reshati ishim në një grup, Reshat Nurboja, neve ishim me një grup.

Tjerët masandej kishte grup, grupi i grave që ato u kujdeshin përreth nanave, grave, për dhanien e ndihmave. U ndamë në disa grupe. Unë isha në grupin për furnizimin me ushqime, me medikamente medicinale, domethanë medikamente mjekësore dhe higjienike për furnizim të qytetareve të

shpërngulur brenda për brenda Kosovës, domethanë refugjatë që ishin mrenda Kosovës. Në atë kohë ishin shpërngul, atëherë domethanë prej Drenice, lufta në Drenicë, ish mbush qyteti me fshatarë nga Drenica, nga pjesët tjera të... të zhvendosur.

Ndërkohë, u paraqit nevoja që të shkojmë në ato zonat ku edhe ish lufta, brenda domethanë brenda në luftë, kështu që aktiviteti jonë veç u zgjeru. Më kujtohet ndihma e parë që e kemi çu, ndihma e parë që e kemi çu ka qenë një fshat Vojnik, fshatin Vojnik, fshat në Drenicë. E kemi çu me një kamion të madh, e kemi mbush ndihma, kemi shku se na shkojshim derë em derë kërkujshim në çdo firmë, në çdo organizatë kërkujshim ata që kishin, nëpër barnatore, nëpër edhe.... Pastaj qytetarët e Pejës në fillim nuk e dishin që na ishim në Këshill të Emergjencës, por e dishin që na jemi vetëm po punojmë për m'i ndihmu ktyne refugjatëve brenda për brenda qytetit. I sistemojshim nëpër familje, i sistemojshim nëpër shpija tjera, i gjejshim vendbanimin, nëpër spital kur ishin smutë, e kishim grupin tjetër që kujdeset për nanat që kishin me lind, për furnizimin e tyre për veshmbathje, me... ishte një, ishte një kshtu, një organizim shumë i mirë brenda Këshillit.

Dhe më kujtohet, po ndërlidhem aty, e mbushëm një kamion na edhe me dërgu në Vojnik, Drenicë. Na nuk e dishim as ku asht' Vojniku, as që dinim ku ka, ku osht' hymja. Punte të policisë kishte çdo vend atëherë. Nejse, e murrëm neve na një kamion, e mbushëm me ndihma edhe unë isha me makinë teme, unë, Angjelina, gjithmonë me Angjelinën kom qenë bashkëpunëtore e ngushtë me te. Unë, Angjelina, ky Mentor Morina edhe Rexhep Lipa. Ata u ulën mbas, neve ishim na dyja përpara, më kujtohet si sot. Ish pak muzgu, na e zgjodhëm muzgun që mos me na vrejtë edhe mos me... policia kështu që pak ma mfshehtas shkojmë, depërtojmë. Kur mbërritëm te rruga aty e Istogut, para se me hi në... para se me shku në Istog që vjen rruga, shkon për Mitrovicë edhe në Istog na ndalin policia. Por, neve ishim përpara me makinë kështu që m'i paralajmëru kamionin që vinte mbas që nëse diçka ndodhë na me...

Atëherë nejse, na ishim me makinë për me bo preventivën që me parapërgatit që ata me kalu, nëse diçka ndodhë ata m'i mbrojtë. Kështu që, ata kalun, kaloi kamioni, neve na ndali policia edhe po na... si sot më kujtohet, më pyeti polici tha, "Ku po shkoni? Dokumentat?" Serbisht, na po ja jepim, po thotë, "Ku po shkoni?" Tash m'i thonë se ajo rruga nga Drenica dihej nga Mitrovica që ku po shkon, e unë i thashë, "Po shkojmë në Istog deri në..." ka qenë atëherë "Ribnjak" u thirrke ajo "Trofta" e sotit, unë thashë, "Deri në 'Ribnjak' po shkojmë për nga një pije në darkë." Tha, "Me këta dytë po shkoni? Me këta dy të mrapshtë a?" (qesh) Ishin ata ma pleq kishe edhe na thamë, "Po, po shkojmë", po tha, "Kqyre ku jemi na..." na u dashke me kamuflu secilin sen, çkado që bojmë, çkado që donë me kamuflu në çdo mënyrë. Nejse, kalum disi qysh kalum, shkum kishe në Istog, ma vonë u kthymë e vazhdum në Vojnik.

Atje e kemi çu ndihmën e parë të kamionit plotë me ushqim, kemi çu me medikamente, me veshmbathje. Kështu që, gjysma ju ka dediku zonës aty, njerëzve që ishin të mbyllun, por një pjesë i ka shku edhe shtabit të UÇK-së që ishte themelu atëherë. Na nuk dishim as që ishte shtabi aty, por e morrëm vesh që shtabi ishte aty. Kështu që, na fillum edhe të dërgojmë ndihma vazhdimisht pastaj, se nga shtabi i UÇK-së që ishte atje depërtojshin ndihmat tona edhe nëpër zonat tjera. Kur u kthym në

mramje mas disa ditëve, pastaj u kthym na, mbas disa ditëve kish fillu ajo... kish fillu fjala, ish hap fjala nëpër Pejë që “More ishin prej Pejës po shkojshin ndihmat në UÇK, po çojshin edhe s’po...” e kshtu vllavi jem në familje teme, unë isha ulun e ai po thotë, “More,” tha, “kena ndi sot që ndihmat, dy veta po shkojshin, dy femna po çojshin ndihma në Drenicë, kush janë more ato?” Unë as familjes time s’i kisha tregu se thojsha bahen marak, merakosën, ish kohë pa kohë, s’i tregova hiç kugjo. Nejse...

Ma vonë aktiviteti jonë filloi veç edhe u begatu, u rrit, u rrit, u rrit. Kështu që, u bo nji Këshill shumë i madh. Pastaj i ndrrumë rolet. I ndrrumë grupet, e ndrrumë edhe zonën edhe unë shkova masandej fillun edhe na të shkojmë, të koncentrohemi kryesisht në zonën e Rrafshit të Dukagjinit. Aty kryesisht i çojshim ndihma shtabit në Glllogjan, shtabit aty komandant në atë kohë për herë të parë e takum edhe Ramushin. Nuk dishim kush osht’ Ramushi, kush osht’ komandanti i zonës. Qëllimi jonë ka qenë jo me ditë kush janë ushtarët, jo me ditë kush janë ata, por qëllimi jonë ka qenë ndihma. Kështu që, na u bamë aty pak na të famshëm, na respektojshin, na jepshin detyra, detyra që... mandej na jepshin edhe me letra urdhna që keni me shku qetu, keni me marrë ndihma në barna ktu në Prishtinë, në Mitrovicë, mandej veç u përcaktojshin detyrat.

Nji ditë më kujtohet kishim me shku në Prishtinë, se atëherë ish rruga Prishtinë-Mitrovicë, Pejë-Prishtinë ish e ndalume, nuk kish qarkullim për shkak se policia nuk lejonte, ishin punktet dhe ish mbyll ajo s’kish qarkullim. Ne për me shku deri në Prishtinë kishim m’i marrë do, goxha do medikamente të mdhaja, ndihma injeksione, seruma që kishim për m’i sjell në zonë, në zonën e luftës, duhej që të shkonim kah Mitrovica, Mitrovica, Rozhaja... Rozhaja në fakt, Mitrovica pastaj me dalë deri në Prishtinë. Unë me Angjelinën u nisëm atë ditë, u nisëm shumë herët në ora 4 të mëngjesit.

Zakonisht unë gjithmonë flija me tesha të gatshme veshun edhe nuk delsha ka dera se më ndëgjojshin prindërit, ja prishi gjumin edhe e merakosi, e për mos m’u merakos ata unë e kapërcejsha dritaren edhe delsha në ballkon e kah ballkoni shpejt dilsha edhe u niseshim ku kishim me shku. Atë ditë qashtu shpejt në mëngjes në ora 4 shkum me Angjelinën, po ish koha e krizës me benzin, nuk kish. Makina duhej të mbushej me benzin, s’kishim ku me marrë. Me shku me marrë nëpër ato pompat e benzinës dyshohej çka po na duhet benzina aq herët. Shkum me nji familje ku e dinim që ata kishin benzinë në shpi mbanin, trokitëm në mëngjes, i zgjumë prej gjumit, po ka qenë shumë... ka qenë njëfarë kënaqësie, sepse kudo që shkojshe ti, natën a ditën nëpër çdo familje, ata e dishin qëllimin tonë, e dishin punën tonë edhe gjithmonë nuk hezitojshin me na dhanë ndihmë, çfarëdo ndihme që ishte e mundshme për ta. Morëm benzinë edhe u nisëm për me shku kah Prishtina, në Prishtinë kah Rozhaja.

Kur erdhëm në Kullë, isha ajo si kufi, zona... aty ish punkti i policisë, jo punkti i vogël, por ishte punkt tepër i madh edhe na ndalën, na ndalun neve dyjave. Ishim veç na dyjat në makinë, ishte shumë herët, ora 4 e gjysë, ashtu 4 sa kishim mbrri, vera sa kish fillu pak me u zbardhë. Unë e kisha çdoherë, e mbaja pashaportën me veti se thojsha çkado që ndodhë unë e kisha vizën e punës për Amerikë, thojsha nëse diçka ikim dikund edhe ta kom pashaportën me veti. Po në të njëjtën kohë e kishim... e kisha edhe nji bombe, e mbajshim gjithmonë në makinë, çfarëdo makine, në makinën time, makinën e

Aferdita Kastratit, se kryesisht me dy makinat tona na endeshim na të dyja, qarkullonim.

Edhe atë makinën, atë bombën e kisha të pshtillun me peshkir edhe aty te ajo ndërruesi i shpejtësive. Policia na ndali edhe na tha, “Kaloni andej ju dyjat,” tha edhe “dokumentat.” Unë po ja jepi dokumentat e makinës edhe po më thotë, “Ooo,” në gjuhen serbe, “kqyre, kqyre kta që p’e lypim, kta që p’e lypim na erdh vet”. E unë thashë, “Mu a?” Tha, “Po,” tha, “le makinën ma andej,” tha, “edhe hajde aty te...” ku ishin policia. Angjelina ndejti në makinë e unë e kisha hallin e bombës se nuk isha na... po thotë Angjelina, po thotë, “Hajt mos ki merak se...” veç tha, “mos ki merak, mos ki merak, se nëse ndodhë diçka, hiç mos ki merak se unë e marr aksionin”.

Kur po më pyesin mu ata, “E çka punon?” Unë i thom, “Jo, more më keni gabu se unë nuk jam ajo”, unë thashë. Qëlloi rastësisht një prej atyne policëve që ishte i Pejës, e disa herë më ka pa se unë ndërkohë kom punu edhe... ndërkohë ma herët gjatë viteve ‘90 deri ‘93 kom punu me Sali Cacën së bashku në një, në një studio të fotografive. Ata vinin edhe kur bonin fotografi, unë isha si ftyrë pak e njoftshme se m’shifshin aty t’u... unë... m’u kujtu ai edhe po i thom, “Ti si qytetar i Pejës nuk e din kush jom unë? M’ke pa njëqind herë, ke ardhë ke bo fotografi te unë?” I tregoi çka punoj unë. “Unë s’jom ajo gazetarja, ose ajo çka po raporton”, se unë raportojsa ndonjëherë edhe në televizion të Tiranës për ngjarje çka ishin. Ai po thotë, “Oooo,” tha, “po, po m’fal, kjo” tha, “punon te ‘Foto Drini’” tha, “kjo nuk asht’ ajo që po kërkojmë.” Edhe tha, “Jo, ta vërtetojmë”, edhe e thirrën me ato instrumentet e tyne në atë kohë, me ato Toki Vokit [Talky Walky] çka janë. E thirrën në qendër në bazë, si duket ata mëngjesi edhe... mëngjesi herët edhe ishin në gjumë, a kumeditë edhe shpëtum.

Masandej, shkum në Prishtinë, kishim ndërkohë m’i marrë edhe do ndihma financiare që na ishte... që i kishte dërgu Shtabit [Këshillit] të Emergjencës, i kishte dërgu, i kishin dërgu qytetarët e Deçanit që ishin në Gjermani, i kishin dërgu shtabit të... shtabit... shtabit qendror në Glllogjan për ndihma, për me ble, me marrë ndihma, me ato mjete me marrë ndihma. Kështu që, neve shtabi na... plus në të njëjtën kohë kur shkum m’i marrë ato medikamentet në Prishtinë, na udhëzoi që ku m’i marrë edhe ato mjete, ato mjete financiare që kishin ardhë deri në Prishtinë. I morëm me vështirësi, me vështirësi të mdhaja ashtu i murrëm, po e kalum diqysh ashtu.

Po du me thanë që e kemi bo një punë me shumë rrezik, mirëpo na nuk e dishim çfarë rrezikshmërie asht’ ajo se e kishim një qëllim. Qëllimi jonë ka qenë që me ndihmu edhe që ne me sakrifiku veten s’u merakoseshim shumë, përveç që i merakoseshim shumë prindtë, na për veti nuk kishim gajle. Bile ndonjëherë shumë shpesh baba edhe kishte shumë atë merak që më thojke, “More unë nuk po kom gajle që po t’vrajnë, a që po të bajnë diçka. Unë gajle e kom që mos po të ndodhë diçka tjetër, mos po bojnë ato çka ata e bojnë”. Domethanë, në atë, e kish merak, se ka ndodhë kuptohet çnjërezimet, na ishim femra, të reja, kohë e pa kohë qarkullonim nëpër qytet, nëpër fshat, nëpër kudo, kështu që... po fatmirësisht nuk na ndodhi kurgjo deri në atë kohë.

Kshtu ka pasë raste, ka pasë raste në këtë Këshill ku jemi te Këshilli i Emergjencës, ka pasë raste kur kemi shku njëherë... kemi bajtë edhe të plagosun prej zonave, nëpër qytete, kemi pru të plagosun prej zonës së luftës kemi pru në spitale apo nëpër spitale mobile që i kemi vetorganizu nëpër qytete. Ka

pasë raste për shembull, kur kom shku njëherë... kemi shku në Isniq për me çu ndihma, jemi taku me ata të shtabit të Isniqit, kemi shku edhe m'i pa do të plagosun, fëmi që i kishin plagos policia serbe prej largësisë, kishin plagos shumë fëmi, disa fëmi në fshatin aty. Shkum na m'i vizitu ata fëmi edhe me ditë gjendjen e tyne, kështu që e vlerësojshim çka ka nevoje e pastaj tjetër ditë dërgojshim ndihma. Shkum atë ditë në Isniq. Kur shkum, në vend që të shkojmë na t'i shohim ata, na u rrezikum vetë se na vërejtën si duket edhe aty na gjuajtën, filloi njëfarë ofanzive e vogël në Isniq e u detyrum na të kthehemi mbas edhe i lamë ashtu siç i lamë. Pastaj shkum tjetër ditë, një ditë tjetër edhe i dërgum ndihma, i dërgum çka ishin ato, kryesisht, kryesisht ndihma mjekësore ma së shumti kanë kërku edhe ushqime.

Më kujtohet një rast tjetër që osht' një rast shumë me u kujtu, ka qenë rast shumë specifik me një të plagosun. Ishte e dille, atë ditë edhe vendosëm që sot të pushojmë, mos të shkojmë askund, të pushojmë. Sa kom mbërrë në shpi, sa kom fillu jom relaksu pak me pushu kur m'ka cingërru telefoni dhe njëri prej shtabit, prej Këshillit po thotë, "Lumka a po vjen se e kemi... e kom gjyshen smutë". Zakonisht ka qenë ajo parolla e lidhjes "E kom gjyshen smutë." "Ku e ki gjyshen smutë?" Po më tregon në cilën shpi se i dishim adresat ku me shku. Edhe shkova, thanë asht' një i plagosun, e kanë pru një të plagosun prej vendit të luftës në një fshat aty, Loxhë, e kanë pru prej frontit. Pastaj më kujtohet ai rasti, një rast kur një të plagosun që ishte plagos dikun në zonat e luftës në Rrafshin e Dukagjinit edhe më tregojnë mu, më thrrasin mu qysh tregova ma herët. Unë shkoj me Angjelinën te doktor Isa Kaliqani, e thrrasim në shpi, më kujtohet ai ishte duke dreku, bile ia ndërpreme drekën, më tha, "Qe veç një moment ta marrë çantën", e mori atë çantën e mjekeve që ishte me ato instrumentet e tij dhe me makinë e dërgum në Loxhë.

Ai ishte plagosur rond, ai djali ishte një djalë i ri, s'e di a i kishte njëzet vjet. Ishte i plagosun ktu {tregon vendin ku ishte plagosur}, plumbi i kishte dalë në anën tjetër. Mirë, ne jse, ia dha atë ndihmën e parë, e morëm na, por në ndërkohë i lajmërum grupit të emergjencës që ishin në Pejë atë ditë, Reshatit edhe Mentorit, i lajmërum që na jemi ktu, "Veç jemi ardhë te ai i plagosuni, së shpejti do ta sjellim në Pejë, po organizojeni vendin ku me çu, çka me bo". Shkum na e morëm atë të plagosunin edhe e futa, e futëm në makinë të Hadi Dodës më kujtohet erdh ai. Hadi Doda ka qenë njëri nga grupi jonë, aktivist, e me makinë tina e sjellëm deri në Pejë. Në rrugën "Ramiz Sadik" aty ishte një mjek, Shemi, Shemi Muhaxheri ishte, e kishte ambulanten e vet. E kishte edhe atë farë *X-Ray* qysh i thojnë, atë farë rentgenin, rentgeni a si i thojshin për fotografim, e kishte domethanë ambulanten private. Ai u... me kshtu, vetëvullnet e hapi atë ditë ambulanten edhe shkum edhe e bonëm atë... të plagosunit ja bonëm *X-Ray*-in edhe e pa plumbi ku asht'.

Duhej një intervenim kirurgjikal, por atë ditë nuk kishim mundësi me bo dhe duhej me dërgu dikund nëpër familje për me strehu. Unë thashë që, "P'e marrë unë në shpi teme, po e strehoj për disa ditë derisa të vijnë mjektë dhe ta operojmë", po këta, anëtarët tjerë që ishin të Këshillit thanë, "Jo, ti nuk guxon, asnjëri prej neve nuk guxon sepse e rrezikojmë misionin, e rrezikojmë Këshillin." Kështu që, e pyetem atë djalin, "A e ki dikond ti të familjes që osht' i familjes të afërm, kshtu qysh i thojnë 'akreba'? A ki dikond në Pejë?" Ai tha, " Po." Na tregoi ku. Shkum neve, bisedum me atë familjen, "A pranoni që

ta sjellim për disa ditë?” Ata sigurisht që pranun edhe na u kthymë edhe e morëm tash me dërgu.

Atë ditë ishte e dille edhe ish, në atë kohë ish kampionati, më kujtohet si sot, kampionati botënor i futbollit edhe atë ditë lujke Jugosllavia me një Gjermaninë më dukët. Eh, dita ish atë ditë e zbrazët, qyteti. Shqiptarët kishin hy brenda se nuk dilshin e serbtë domethanë ishin mbyllë me pa lojën, aty këtu ndonjë polic sa për, që ishin të detyrum për me ndejtë. E mora unë makinën time, e shtreva makinën, e qitëm atë të plagosunin edhe e mbulum me disa kartona kishe do paketa e do sende, gjoja që kemi mall, diçka ksi mall ushqimor a diçka. Edhe unë po du me dërgu vetë. Po më thotë Reshati, po thotë, “Jo, se me bo me të nxonë ata, unë ty nuk t’lo vetum. Ma mirë le të na nxojnë dyve sesa ty vetun,” tha edhe, “unë [nuk] t’lo”. Erdh Reshati me mu edhe hypi mbas. Të plagosunin në makinë krejt të shtrimë, e kisha shtri atë farë karrigën afër aty të bashkudhëtarit. Kur kemi dalë prej rrugës “Ramiz Sadik”, te pompa e benzinës qe policia, edhe veç um kanë ndalë. Ish rrezik se me ta nxonë të plagosunin në makinë dihet çka ndodhte.

Edhe unë tash për ni moment Reshati tha, “Ouuuu Lumka ramë”, për një moment unë veç m’u ka kujtu dhe e kom çelë xhamin edhe i kom thonë serbisht atij, “A nuk je t’u e kqyr lojën a?” Që veç më ka ra ndërmend, “A s’je t’u e kqyr lojën a?” Serbisht, ai po më thotë, “Eh,” tha, “ça me bo”, edhe u çelë diqysh edhe tha, “Ça me bo,” tha, “detyra osht’ detyrë.” Krejt në serbisht folëm, unë, po thotë, “E ti ku po shkon? Pse s’po e kqyr ti lojën?” Thashë, “Jo bre, unë qetu p’e çoj, e kom do mall, e kom një dyqan aty poshtë.” “Ku e ki dyqanin?” Thashë, “Qaty te Kazerma, përball Kazermës së ushtrisë,” thashë, “e po duhet me çu do mall në dyqan.” Tha, “Cili asht’ dyqani yt?” Unë, m’u kujtu që rrugës gjithmonë ka qarkullojshim, një dyqan me titull e ka pasë “2 K”, e i thashë, “E jemja osht’ ‘2 K’, qai dyqan osht’ i jemi. Hajde ndonjëherë në kafe”. Ai tha, “Hajt se vijmë, hiç mos ki merak se vijmë qeto ditë”, unë, edhe kalum, pshtum atë ditë. E dërgum masandej, masandej atë të plagosunin në atë vend, po. Kështu që, te na misioni jonë ka qenë në rrezik në çdo moment sepse vepra, puna jonë që ish, ish punë e rrezikshme. Mirëpo, nuk kemi pasë fort merak, kemi pasë detyrën, qëllimin tonë me arritë ato çka kishim veç në shënjestër. Kështu që, besoj që e këna kry me nder.

Kështu që, ndërkohë, ndërkohë gjatë kësaj kohe, organizata e “Mjekeve Pa Kufi” erdh për të punu në Kosovë dhe një degë, një nga degët e saja e hapen nifarë, e hapen edhe në Pejë. Kështu që, meqë unë, meqë unë e disha terrenin mirë, terrenin e Rrafshit të Dukagjinit e disha terrenin, flisja gjuhën serbe, dijsa me vozit, kisha makinën lejen për vozitje, gjuhën angleze e zotërojsha diqysh. Dhe kështu që, ata të shoqata e “Nënës Terezë” me seli në Prishtinë, sigurisht me direktiva të tyne, s’e di nga kush direkt mirëpo kishin dërgu që deri... e kishin drejtu ata me ardhë te unë. Më ftunë mu m’u taku edhe m’thanë, “Na duhesh qeshtu, qeshtu për me punu me neve” edhe unë thashë që, “Nuk jam, po unë e kom punën time, punoj sepse isha e angazhume në Këshillin e Emergjencës dhe nuk...” atyne nuk i tregojsha se çka punoj, por e kom punën time të përditshme, ata thanë “Po, s’ka problem, bile me na ndihmu ashtu kshtu”. Edhe unë u konsultova me këta të Këshillit të Emergjencës, ata thanë, “Kjo asht’ puna ma e mirë që neve na duhet, veç prano dhe vazhdo me ta, vazhdo”.

Kështu që, unë vazhdova, ditën punoja me ta, në mramje e kryjsa punën. Vazhdojshim pastaj me

Këshillin e Emergjencës me dërgu ndihma, se kryesisht na funksionojshim ashtu natën sesa ditën, se ditën dukeshim kështu që natën në terr kryhen puntë ma mirë. Edhe pastaj, fillova kshtu punova ndërkohë derisa, derisa na hetun demek që jemi t'u punu dhe na përndjeken dhe u shpërndamë ma vonë. Me arrestimin e Reshatit, Reshatin... Reshat Nurbojen e arrestuan, pastaj na ikëm të gjithë, dikush në drejtime tjera. Unë e kisha vizën, e kisha pashaportën dhe vizën amerikane, sa shkoj jo nëpër Maqedoni ose në Mal të Zi e në Shqipëri vendosa të vi këtu direkt në Amerikë për një kohë shumë të shkurtë. Për nja dy javë a tri, mendojsha ashtu që përfundon ndoshta kjo, kjo ngjarje edhe kthehna prapë në Kosovë me vazhdu për me ndihmu në njëfarë mënyre atë çka kisha mundësi unë me ndihmu, por nuk ndodhi ashtu se lufta veç murrë përmasa ma të mdhaja dhe unë ndejta në Amerikë ma gjatë.

Rexhep Myftari: Cila ka qenë lidhja, lidhja në mes të Këshillit të Emergjencës edhe ma vonë UÇK-së? Sa, cili ka qenë ajo vija ndarëse ose bashkëpunimi ose si janë shkrirë me njona-tjetrën?

Lumturije (Lumka) Krasniqi: Kshtu na kur jemi formu, na jemi formu vetëvetiu. Domethanë, jemi formu në bazë të nevojës për ndihma, për m'i ndihmu, për refugjatë, për popull, për të plagosun, për ndihma, për ushqime, çkado që, çkado që populli kishte nevojë për neve, jo për neve, por në përgjithësi dhe na ishim ata që mundeshim me ofru. Mirëpo, vet pastaj nevoja nëpër fshatra ku neve shkonin, në fshatra për m'i dërgu ndihmat fshatareve, kontakti jonë u mundësu që të kontaktojmë edhe me ata fshatarë që ishin të lidhun me shtabin, të lidhun me UÇK-në, domethanë kish ushtarë ashtu. Edhe, ata vinin çdo ditë edhe sa herë që shkonim aty në fakt ata neve na tregonin që çka kena nevojë, "Kemi nevojë për kta, për kta, për kta, për kta." "Kush ka nevojë?" "Ka nevojë ky fshat, ka nevojë ky fshat, ka nevojë shtabi, shtabi i UÇK-së".

Dhe, një ditë ne shkum në shtabin e UÇK-së në Glllogjan aty, dhe prej aty kontaktum me ata dhe fillum, vendosem që të lidhemi, që nëpërmes neve, ata çdo nevojë që e kanë për furnizim përveç armëve se na nuk furnizonim armë, ata me ardhë. U furnizonin vetë por çdo furnizim tjetër për medikamente, me ushqime, me higjienë, me çkado që... ushqime ma pak, por qaq sa kishim mundësi por kto çka ishin ma rendësi medikamentet mjekësore, kto pejnat, serumat, barnat, kto antibiotikët e kto, na i mbledhnim edhe ata nëpërmes neve pastaj u furnizojshin. Vendosën që nëpërmes neve, nëpërmes tjetër askujna, veç na ishim ata që i furnizonim ata se kishin besim. Kështu që, bile-bile, bile-bile në atë zonën ku, ku vepronte UÇK-ja e atëhershmit në zonën e Dukagjinit, domethanë prej Deçanit, ato fshatrat e Deçanit e deri në Glllogjan, Isniq, Llukë, e Prapaçan, e Pozharë, e Lumbardh ato, krejt ato fshatrat ne duhej t'i kalonim edhe për me shku deri atje te UÇK-ja.

Po në krejt ato, ato fshatra ishin... qarkullimi nëpër ato fshatra s'ka guxu asnjo i jashtëm të qarkullojë, të hyjë aty, krejt kto fshatrat i kontrollonte UÇK-ja, dhe pa leje të posaçme s'ki pasë mundësi të hysh ti aty. Nëse nuk je i fshatit s'ki pasë mundësi me hy, aq ma pak na që ishim të panjohun të qytetit, pa marrë parasysh që shtabi neve na njifte, ata kryesorët të shtabit që na njifshin, po qarkullimin na aty e kishim të rrezikum, ditën, natën se s'dishin kush jemi na. Kështu që, më kujtohet si sot Dauti, Daut Haradinaj na pat' autorizu edhe ma dha mu autorizimin që në emën të grupit të emergjencës të

qarkullojmë lirë. Domethanë, unë e kisha lejen e posaçme, shkruante aty, “Autorizohet Lumturije Krasniqi që në emën të grupit të qarkullojë e lirë në zonën e UÇK-së”. Kështu që, na kur qarkullonim duhej ajo si letër identifikimi duhej që me atë të qarkullonim me atë letër. Kështu që, kemi qenë të privilegjum. Kjo asht’ lidhja jonë e parë.

Lidhja tjetër e dytë osht’ kjo që në kohën kur... ishte fjala kur ushtritë ato shtabet që ishin, disa shtabe të ndryshme, u dakorduan që ta formojnë një shtab qendror të rrethit, Rrafshit të Dukagjinit. Neve na autorizun që t’i furnizojmë, t’i furnizojmë dhe t’a mobilojmë apo si ta quajmë kazermën e ushtirës së UÇK-së që atëherë duhej, u planifikohej që të bëhej në fshatin, në shkollën e Prapaçanit, në Prapaçan. Aty, pastaj na e organizum edhe në Pejë, sidomos kryesisht shkum nëpër vende, nëpër vende te Devollt, “Bananja” në atë vakt, kto ishin të... barnatorja “Lika”, si sot më kujtohet, ata ishin kryesorët që na patën furnizu, që na furnizojshin ne më të gjitha ato nevojat që kishin na, që na ja kërkojshim atyne për shtab. Kështu që, shkum te Devolli, u furnizum me sunxhera, me shampona, me ato. Domethanë, na ishim ata që e furnizum atëfarë shtabi të përgjithshëm të ushtrisë së UÇK-së, të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Edhe pastaj, ata e kishin formu, e kishin formu shtabin, domethanë, Shtabin Qendror, domethanë, pjesëmarrësit, Shtabi Qendror ndër ta në listë. Unë nuk e kom ditë, mirëpo se na atëherë veç ikëm se u shpartallu ajo punë, në atë listë kishim qenë unë, Reshati dhe Angjelina me Aferditën, në Shtabin Qendror të UÇK-së që duhej të funksiononte aty. Kështu që, kur, kur e kanë arrestu Reshatin dhe e kanë gjyku edhe e kanë dënu, në atë aktakuzë kemi qenë edhe na, ndërkohë unë kom qenë e akuzume për luftë e për... si të tjerë, për terroriste, ja... por, fatmirësisht unë ika, por fatkeqësisht Reshati, Reshatin e arrestun edhe ka kalu tortura shumë çnjerëzore deri në burgun e Dubravës, deri mbas luftës kur jonë kthy në përgjithësi.

Kjo ka qenë lidhja jonë, domethanë na jemi shkri, nuk osht’, na kemi qenë logjistika në njëfarë mënyre, logjistika e UÇK-së, nuk kemi punu në front, nuk kemi vepru në front, nuk kemi luftu, nuk kemi qenë aty në atë ditë, po kemi qenë, kemi qarkullu, kemi qarkullu dhe kemi furnizu në emën të UÇK-së. Domethanë, edhe në qytet, se shumë me randsi me cek këtë punë, kur fillun me na njoft pastaj qytetarët neve, grupit tonë të ngushtë na e njëfshin, na ofrojshin ndihma. Fshatarët prej fshatrave tjera na bishin ushqime, më kujtohet si sot, na bishin ato kacat me djathë fshatarët, dikush na bike miell, vaj e sende për m’i shpërnda, pa e ditë kush janë ata veç vullnetarisht edhe i bishin në hamam e kishim atë pjesën aty ku organizonim. Eh, aty krejt furnizimet i shpërndanim në mramje kudo ku kish nevojë.

Por, më kujtohet si sot shumë me randësi dhe me kënaqësi osht’ ajo me cek, kryesisht na rrishim... osht’ ajo lagjja në Pejë i thojmë të lagjja e... te poshtë te vorret e vjetra, vorret e Kakariqit, aty kryesisht u takojshim në një shpi, një shpi të njërit prek aktivisteve tonë edhe kur hynim na aty në atë lagje, ka qenë lagje e madhe, por e rrethume diqysh si e mbyllun, te Kaleja, “lagjja e Kalasë”. Si hynim na me makinë, makina jeme simbolizohet si makina e UÇK-së, edhe kur hynim na aty, rinia aq mirë organizohet edhe e bllokoniin rrugën, e bllokoniin rrugën kishe po lujmë, as me pasë mundësi asnjë

polic, asnjë i huj me hy brenda derisa na të organizohem, të furnizohem, t'i mbushim makina, çkado që kishim edhe për me qarkullu në UÇK, me qarkullu nëpër zona të luftës.

Kështu që, ta cekim, misionin jem me "Mjekët Pa Kufi", çka ish tash gjatë punës që beja me "Mjekët Pa Kufi", ndihmat që i jepsha në Këshill të Emergjencës. Ditën me makinën e "Mjekeve Pa Kufi", me ato gjipat e mdhaj ish, shkonim si konvojë, dy makina gjithmonë nga dy makina niseshim për me... po unë çuditërisht unë e caktoja vendin ku dojmë me shku sot, se ata nuk e dinin rrugën, ishin me, ishin me polici, ishin me ushtri, s'kishim hymje kto. Unë i disha ato mundësitë, Plani A, Plani B, se e disha rrugët ka me hy, ku me dalë. Kështu që, domethanë unë e caktoja ku me shku, por rrugës e kisha edhe një mjeke, mjeke që punonte shqiptare, po Besa, meqë ata konsideroja që nuk dinin shqip, ata që ishin me neve, ata francezët apo të Belgjikës, kur i shishe, dy ishin me ne, unë i thojsha Besës, "Besa," se ish Besa me mu, Besa Gjilkolli mjeke, "Besa merre një laps ti rrugës kur të nisëm na, unë kur të thom ty një vijë qetash, qetash, ti veç bone vijë dhe shkruje ku".

Kështu që, kur shkonim na rrugës, e shishim një *check point*, një punkt të policisë, e shishim e i thojsha Besës, "Besa," ajo shkruante qetu, për shembull në Lubeniq, ktu në Raushiq domethanë e dishim, e në mramje kur unë i tregojsha atyne që ku ka, ku ka polici që ata qarkullimin nëpër ta kenë ma të kujdesshëm për me shku, "Kur të shkoni për... nëpër anën tjetër të rrugës, domethanë kah Juniku andej për me dalë në Shqipëri" që qarkullonin për me u armatos, me domethanë për me pasë kujdes në qarkullim. Edhe kjo ka ekzistuar, edhe kjo. Ose shkojsha nëpër fshatra i thojsha, ata më njifshin mu që isha e Këshillit të Emergjencës, po heshtnin kishe që nuk po m'njofin dhe kur shkojsha unë, thojsha, "Tregoni çka keni nevojë ju? Çka keni nevoje me ju sjell?" Ata thojshin, "Qekjo, qekjo, qekjo", kta thojshin të "Mjekeve Pa Kufi", "Osht' e tepërt, nuk mundëm", i thojsha, "S'ka problem, pak diçka i çojmë". Kështu që, unë e disha çka kanë nevojë e në anën tjetër me... ka "Nëna Terezë", me Këshillin tonë furnizojsha edhe në mramje veç i dërgojshim ato ndihmat atje.

Ka ndodhë, ka ndodhë që... edhe përshtypja e parë që m'ka lanë shumë përshtypje të mirë, organizimi që e kom pa që ka qenë organizimi jashtëzakonisht i mirë në Glllogjan në shtabin e UÇK-së kur kemi shku për herë... disa herë, por herën e parë që e kemi pa, kuzhina e ushtrisë, kemi pa buka që piqej aty gatuhej furra e bukës, kuzhinieret. Domethanë, një organizim tepër i mirë edhe si kujtim e murrëm, e murrëm nga një copë bukë që t'ua, ta diskutojmë, të bindim njerëzit që në UÇK ka organizim, se njerëzit disa ishin skeptik kështu në besim, çfarë organizimesh, por edhe e dërgum kah një copë, kah një kilogram bukë na, taman bukë furre, furre të UÇK-së edhe me çu sikur, sikur me çu prej... prej ndonjë tempulli, kështu tempulli të Zotit a kumeditë, ajo buka me kërku pak se osht' buka e UÇK-së, ajo ishte përshtypje që...

Ka ndodhë, rasti tjetër për shembull kur kemi shku që kemi qenë shumë në rrezik, unë me Angjelinën, prapë me Angjelinën, çdoherë me Angjelinën, kur kemi shku në Prishtinë me marrë, kishin qenë disa pako i kishin përgatit atje në Prishtinë edhe shkum na m'i marrë por me tren. Atëherë filloi qarkullimi i trenit Pejë-Prishtinë edhe na shkum me tren. Kemi hyp në tren, kur kemi shku në zonën e Drenicës kënaqësia ma e madhe osht' kur kemi pa njerëz të armatosun, na u duke që... edhepse neve shishim

çdo ditë në këtë zonën tjetër, por në Drenicë ato lëvizjet e para të UÇK-së, na u dukshin që... na u dukë diçka tepër e madhe.

Rexhep Myftari: Çka ka ndodhë pas arrestimit të Reshatit, çka ndodhi me juve tjerëve?

Lumturije (Lumka) Krasniqi: Po, pas arrestimit të tij na u shpërndamë të gjithë. U shpërndamë, faktikisht disa në Mal të Zi, disa në... disa në Shqipëri, disa andej, unë meqë e kisha vizën, tregova vizën amerikane u nisa për... erdha në Amerikë këtu. Erdha në Amerikë dhe besoni që erdha, atë [ditë] kur kom kalu në... osht' edhe shumë interesant me tregu edhe atë rrugëtimin tim prej Pejës deri në, deri në, deri në Prishtinë. Erdha, erdha prej Pejës, kur kom ardhë deri te Kulla, se po harroj edhe emnin e vendit, te Kulla aty te Rozhaja, para se me hy në Rozhajë. Aty kom ardhë edhe më ka pru vllau, m'ka sjell me makinë, po jo me kalu andej se unë isha e kërkume, po u ndala. U ndala ma poshtë. Ndërkohë, po kalon një makinë që ishte rastësisht, edhe fatmirësisht një vajzë, femën vozitke makinën, edhe ajo ish, nuk e dija që ish serbe, por supozohej që ishte serbe. Se femnat... neve ne atë kohë nuk qarkullonin femnat shqiptare andej.

Edhe, unë p'e ndaloj edhe p'i thom, "A bon me ardhë bre me ty deri në Rozhajë se m'u ka prish makina edhe s'po kom qysh me shku e me ardhë, veç të shkoj të marrë diçka e të kthena e pastaj të rregulloj e të kthena ta marrë makinën se e kom të kushtëzume?" Edhe ajo po thotë, "S'ka problem hajde me mu, nuk muj me t'çu deri ma tutje," tha, "veç deri në Rozhajë të çoj." "Okej." Hypa unë me to në makinë edhe u përshëndeta me vllaun, s'kisha asnjigjo, veç pashaportën, anjigjo, veç një çantë të vogël. Erdha... kalum, asnjë nuk na kontrollun se ajo serbja njihej, ajo bonte tregti, tregti, qëlloj e Klinës edhe ajo, u njoftum kishe ndërkohë. Erdha deri... ajo më pruni besa deri në stacionin e autobusëve në Rozhajë. Aty, aty u takova rastësisht me një dajë, djalin e dajës të nonës, kishte qëllu në Rozhajë edhe ai më tha, "Hee Besë, çka ki, çka u bo?" I thashë, "Unë duhna me ikë, qeshtu, qeshtu," tha, "Hajde," tha, "ti se unë e kom atë autobusin, shoferin të njoftshëm." Edhe i tha atij shoferit, "Merre kto edhe amanet po ta lo deri në Prishtinë me çu, amanet në dorë tonde."

Edhe unë shkova në Prishtinë shumë mirë, pa problem e kalum Malin e Zi deri në Prishtinë. Në Prishtinë kur kom mbri, ka dalë djali i tezës me m'prit se në Prishtinë jetonte ai. Kom ndejtë atë natë, kom bujt te ai në Prishtinë. E kom nxirr biletën për Beograd, për Beograd se ish aeroporti i vetëm që ke mujt me fluturu ka qenë në Beograd. E kom nxirr biletën për, për... djali i tezës ma ka rregullu atë çështjen e biletës, biletën për me ardhë në Amerikë, shpejtë e shpejtë. Të nesërmen në mëngjes me autobus prej Prishtine deri në Beograd jom nisë vetum, kom shku në Beograd, kom mbri në mramje domethanë ma vonë, fluturimi ish tek të nesërmit për, për Amsterdam, masandej prej Amsterdamit me ardhë ktu në New York. As nuk e disha ku po shkoj, as s'disha ku... se unë kisha mendjen që me shku në Oklaoma se aty e kisha vendin, e kisha shoqërinë, e kisha vendin e punës që kom mujt me vazhdu, se shkolla ime ishte e lidhun me Oklahomen, e kisha vendin, e kisha shoqërinë, të gjitha, i kisha të gjitha mundësitë me vazhdu jetën në Oklahoma. Mirëpo, fati e deshti që nuk gjeta biletë për Oklahoma, e vetmja biletë ishte për New York që kisha gjetë në atë kohë dhe ishte sezona në atë kohë, sezona e udhëtimeve.

Kështu që, shkova në Beograd, mbriva. Kom shku atë natë në hotel, hotel “Slabija” po më doket edhe kom fletë vet. Në mëngjes jom çu, autobusi prej atyhij nisej në aeroport, direkt, aeroport, autobusi që osht’ *shuttle bus*. Kom hy aty edhe jom shku në aeroplan, në aeroport pa kurrfarë problemi. Paramendoje po kërkohem atje krejt, ktu krejt pa problem po legjitimona, po e kalova. Unë e di, unë e di çfarë, çfarë zori, çfarë halli kom qenë kur kom kalu, derisa jom kontrollu prej policisë e doganierit, doganës aty çka osht’ në aeroport. Kur e kom kalu për me hy në aeroplan, kanë qenë ato telefonat, telefonat publike, aty e kom thirrë nonën, nonën teme në telefon edhe i kom thanë, “Tete,” se tete e thirri nonën, “Tete,” thashë, “mbriva”. “Ku je?” Tha. I thashë, “Jam në aeroport, po hypi në aeroplan pa merak. Të lajmërona kur të mrrij në Amerikë.” Edhe ajo u shliku pak. Unë kur, kur kom mbrri ktu [New York] nuk kom ditë ku me shku. S’kisha, s’disha ku.

Por, ndërkohë djali i dajës tem, domethanë çika e dajës e ka ktu djalin, por unë s’e kisha taku ato me 20 vjet, por e kisha numrin e telefonit edhe rastësisht, rastësisht veç në atë bllokin që asht’ në Amerikë e kisha numrin edhe vendosa thashë p’e thrras në telefon. Ndoshta nuk e dinin kush jom por p’e thrras në telefon. E thrras unë në telefon prej aeroportit edhe i thomë që, “Unë jom qekjo, qekjo edhe kom nevojë derisa ta nxirri biletën.” A din, shumë prekëse osht’...

Rexhep Myftari: A mundesh me na tregu kur ke ardhë ktu në Amerikë qysh je gjind, kush t’ka prit, qysh ka qenë ndjenja me ardhë prej zonës së luftës me ardhë në New York?

Lumka Krasniqi: Uhhhhhh... osht’, osht’.... Ktu jeta, vështirësitë e jetës ma së shumti ktu m’kanë, kom pasë vështirësi. Jeta ma e vshtirë e kom kalu prej ardhjes në Amerikë derisa jom pak ambientu, derisa jom gjind. Kur kom mbrri në New York në aeroport, ka qenë shumë vonë. Por, edhe diçka veç një koincidençë, ta tregoj një rast. Fati, ktu këtë herë kish qenë në anën time. Unë kurrë pa ditë që viza e Amerikës, viza ime ka skalu, ka skadu më falni, thashë *expired*... ka skadu atë ditë me 10 korrik. Kur kom ardhë unë ktu në ora... ka qenë fluturimi ka qenë, ka qenë shumë i vonshëm edhe kur kom ardhë kom mbrri edhe 20 në 12h, domethanë me 10 korrik.

Me datë... me 20 në 12h, kur jom paraqit para atij policit të doganës në aeroport edhe e ka pa ai... e ka pa vizën ai edhe m’tha, “Ti nuk mundesh me hy në Amerikë sepse viza jote ka skadu”. Edhe unë thashë, “Ka skadu?” E kom marrë e kom kqyr dhjetë, e dhjeta ditë. Thashë, “S’ka mundësi se,” i thashë, “unë kom ardhë prej Amsterdemit, kërkush s’më ka ndalë as...” Tha, “Jo, jo, viza jote të ka skadu. Ti s’mundesh me hy në Amerikë”. E unë, pak a shumë në atë kohë kom qenë pak ma e gjindshme e i thashë, “Jo, jo, jo, unë nuk bisedoj me ty,” thashë, “unë kom edhe njëzet minuta me hy. Ti mos em mbaj mu ktu me m’kalu koha, qitëm në atë anë, atëherë bisedojmë”. E kaloj unë atë domethanë, “Të kaloj kufirin” në atë kuptimin, kufirin, doganën e aeroportit, thashë, “atëherë na bisedojmë”.

[Video-intervista është prerë këtu, me çrast edhe fillimi i fjalisë]

... tjetër edhe e thirri edhe i thomë, ajo quhej Rabë, thashë, “Unë jom Lumka, kshtu, kshtu”, edhe po prezantohna. “Noshta osht’ vonë, po nuk kom ku me shku, kom ardhë sot,” thashë e, “a kish pasë

mundësi unë me ardhë te ju?” Ajo tha, “As mos e diskuto këtë punë, po nuk kom makinë me ardhë me të marrë,” tha, “jom shtatëzane.” Se ish shtatëzane pak para lindjes. Tha, “Shabani nuk osht’ ktu, po nëse ki mundësi me marrë ni taxi, merre taxin unë ta paguj, veç hajde qe adresën”, si shqiptarët qysh jemi kudo (qesh). Atëherë, ne jse shkova unë atje e atë natë mbrriiva. M’ka prit shumë, kom tepër mirë m’ka prit kështu që s’ia harroj kurrë asejna. Kom ndejtë te ta tre muj e gjysë.

Mirëpo, ndërkohë unë kërkoja punë. Kërkoja punë nëpër gazeta, nëpër kshtu nuk disha ça, dojsa me punu diçka. Lypa, po... kur nja mas dy-tri ditëve unë e thirra një agjension për me marrë biletën për me shku në Oklahoma, dojsa me shku në Oklahoma se bisedova me ata, ata më thanë, “Hajde!” Por, fatmirësisht nuk kish bileta apet në ndërkohë. Edhe plus ky kushëriri jem, ky djali i dajës Shabani ma mbushi pak mendjen, “Ku po donë me shku? New Yorki osht’ për neve, për komunitetin tonë, i ndihmojmë njeni-tjetrit, ku donë me shku atje lerg që osht’ lufta, ki afër dikond, ashtu- kshtu” edhe vendosa me ndejt në New York. Ndejta në New York, po fati mbas dy jave unë gjeta punë.

E pash e morra gazetën ditore, gazetën “Koha Ditore” në atë kohë, ktu dilte në New York. E bleva gazetën, çdo ditë me lexu, m’u informu çka po ndodhë. Internet atëherë ishte ma vështirë, s’kishim internet e kshtu, kish por jo aty ku isha unë, edhe m’u informu. Kur p’e shoh në gazetën “Koha Ditore” ato shpalljet për punë, një nga agjensionet, një agjension shqiptar kish, po kërkonin një punëtore, ndihmese sekretarëshë, agjente për rregullimin, agjente për bileta domethanë për rezervimin e biletave. Edhe unë i thrras pa hezitim, i thrras, edhe i thirri në telefon edhe i thomë, “Kshtu, kshtu, kshtu, unë jom kjo, po i referona gazetës”. Ai po më thotë, tha, “Sa vjeçe je?” Kushti i parë, sa vjeçe je? Edhe unë po i thomë, “Çka ka të boj ktu me vitet të mia?” Tha, “Jo,” tha, “veç me qenë shumë re, me qenë shumë e re, kto të rejat po vinë e po dalin, po e lajnë punën në gjysë” tha. “Ti,” thashë, “unë jam 34 vjeçe”, hala s’i kisha ba 34 vjet. Tha, “O shumë mirë,” tha, “atëherë ku jeton? Ku banon?” Unë po thomë, “Në Manhattan 130 e sa, 180 e sa rrugë”. Tha, “Ou na jemi, fatkeqësisht na jemi në Brooklyn edhe shumë larg je, nuk mundesh me udhtu se osht’ shumë vështirë për ty me udhtu”. Unë edhe aty i thashë, “Jo, jo, jo,” thashë, “unë jom përkohësisht ktu te kta, se jom me një familje, se unë kom vendos ku ta gjej punën me marrë banesën.” Kështu që, s’doja me lëshu atë punë. Edhe thanë, “Mirë”, edhe vendosa. E lamë një takim për kshtu termin për *interview*, erdha, hera e parë që erdha në Brooklyn, orientimet me trena me ato pfff, nuk e kisha qaq problem, u gjindsha mirë.

Erdha e mora punën, domethanë më pranun, fillova me punu. Mbas një muj e gjysë masandej kta ku punoja unë, agjensioni ma gjetën banesën, më ndihmun me gjetë një banese shumë afër këtu punës, kështu që pastaj vazhdova. Mirëpo ndërkohë, ndërkohë lufta, ofansivat atje, ato, ato masakrat, ato që filluan në vitet e... mbas bombardimit të NATO-s në Kosovë. Atëherë familja jeme, unë familjen e kisha shumë të madhe, e kom të madhe hala, në fakt e kisha gjyshen, nonën, babën, krejt vllaznit e motrat, motrat të martume, me fmi, me fmi shumë të vogjël, një-nji pesë [vjet], një-nji shtatë, një-nji gjashtë, krejt të vegjël, ma e madhja ka qenë 14 vjeçe prej krejt fëmive. Edhe, domethanë e kisha unë tash preokupimi im kryesor ishte jo veç lufta në Kosovë çka po ndodhë, po e kisha edhe familjen. Ata ikën, gjysma u shpërndanë nëpër Shqipëri. Me sa ditë, me ditë nuk janë taku, me ditë nuk e kem ditë as unë

ku jemi, e kemi pasë atë lidhshmërinë.

Mirëpo, u dogj krejt shpijat, krejt shpijat e tona, vllaznive, e shpija jeme e prindërve, e të gjithëve, me një oborr i kishim shpijat, u dogjën. Çka ma së shumti e kom peng, ajo që më ka mbetë prej krejt asaj çka osht' shkatërru dhe osht' humb janë veç fotografitë edhe librat që i ka pasë, bibliotekën e babës dhe fotografiat që jonë zhduk, domethanë ato nuk kthehen mo kurrë. Ajo ka qenë, bile një kojshi i jemi, një djalë i kojshive ktu jetojke, kojshinë e parë e kom pasë në Pejë edhe më tha në telefon për me më relaksu pak, me më tregu që çka ka ndodhë me shpinë tonde, tha, "Eii Lumka a din çka ka të re?" Unë po i thomë, "Çka?" Tha, "Khu, ish kall krejt mahalla". Thashë, "Ani Arijan edhe shpija jonë a?" Tha, "Bile e juvja mas shumti ka qitë flakë, thanë, 'uuu shpija e Krasniqve veç flakë se krejt ju kishin kallë Lumkës fotografitë'" (qesh), se unë i kisha shumë merak fotografitë e kom pasë kshtu' *debilesë* [dobësi] fotografinë.

Edhe kështu që, ma dhanë lajmin që jeni djeg me ka krejt, po prapë unë s'e kisha fort marak atë, unë veç thojsha a kanë mbijetu, a mos dikush, a u vra ndonjë prej familjes? Por, fatmirësisht prej familjes së ngushtë krejt jonë, krejt jonë gjallë. Po e kisha ma shumë merak çikat, se çikat e vllaut, ato ishin 14 vjeçe, ishin dy- tri, po ishin të zhvillume, të rritshme e ndegjojshim tulifarë tregimi çka po ndodhë me vajza rrugës gjatë, gjatë ekzodit nëpër Shqipëri, nëpër Mal të Zi, po i marrin, po.... Kështu që unë ato e kisha merak çdoherë sa herë që folsha me telefon i pytsha familjen, "Lena ka osht'? Arta ku osht'? Kjo ku osht'?" Edhe e kom pasë shumë merak ma të madh se i kom dashtë shumë. E kom pasë lonë çikën e vllaut shumë të vogël, një vjet e gjysmë njenën, ato veç e thojsha, "Disi ku osht'?" E sot, po du me thanë që për fmi, për fmi e kishim ma merak edhe për gjyshen, se gjyshja ish e palëvizshme, e lëvizshme po ish njëqind e sa vjeçe. Gjyshja në atë kohë, 102 vjeç në atë kur ka qenë lufta, mirëpo kanë shpëtu edhe...

E po këndej në anën tjetër unë në Amerikë e kisha shumë problem tash se... problem, unë nuk e kisha problem për vete, po e kisha merak edhe e kisha atë preokupimin tem kryesor ka qenë ata tash qysh jetojnë. Kështu që, kom punu shumë, kom punu ka ndodhë dy-tri puna kom punu, jo dy, po ka ndodhë një kohë shumë të gjatë që kom punu në dy puna, tri puna, ka ndodhë gjashtë muj s'kom flejt gjumë s'kom mujt... veç me punu edhe për m'i ndihmu njëherë sa ishin në Shqipëri andej-këndeje. Masanej, kur janë kthy kom punu shumë për me i ndihmu për me... për m'u rimëkambë pak, shpinë, jetën, fëmija besa, fëmija m'u shkollu, qeshtu, kështu që, apet jom krenare që diçka kom bo për familje, pak a shumë m'i ndihmu familjes (qesh). Masandej, baba nuk jetoj shumë. Vdiq edhe ai. Erdhën masandej në Amerikë, baba edhe nona erdhën në Amerikë edhe u vendosen këtu me mu. Vendosa t'i kem afër, si prind se atje kushtet pak të vështira me jetu pas luftës derisa u ndërto shpija, jo dimnit ftoftë, prindtë i kisha sado kudo pak ma të vjetër e kshtu' të molisun e besa edhe të mërzitun prej luftës, e prej jetës. I mora ktu pak, erdhën. Kanë jetu derisa baba ka vdek, para se me vdek osht' kthy 2014-tën, 2012-tën edhe kështu që kjo osht' jeta jeme në Amerikë.

Mirëpo profesionalisht punën e kom bo, po, po kom pasë fat, kom pasë fat shumë, shumë kom pasë fat ktu, sepse unë atje isha ekonomiste, kisha përvojë, përvojë me kontabilitet e me financa, kom pasë

përvojë të mirë. Kom punu atje goxha do kohë, 12-13 vjet të mira kom punu taman profesionalisht mirë. Kur erdha ktu, në atë vitin e parë u gjinda në agjension te kta, te kta miqtë shqiptarë që e gjeta atë punën. Mas një viti kalova me një punë tjetër në Manhattan, konsolidatore aty, edhe aty agjente turistike për bileta. Mirëpo, ndërkohë ai pronari më pa që unë e bëja ato kalkulimet, hyrje, daljet vet të biletave çka qysh edhe i dhashë përshtypje dhe një ditë më thirri në zyre, me tha, “Lumka,” tha, “a mos je e interesume, p’e shoh që je kshtu, kshtu, ekonomiste, kontabiliste, a kishe pasë mundësi, a donë, a ki qef me punu *accountant* [financiere]?” “Ky osht’ profesioni jem, me kënaqësi kta e boj ma shumë sesa që bej bileta, rezervimin e biletave”. Atëherë, kështu që vazhdova, punova aty.

Punova mirë, tetë vjet punova, edhe profesionalisht, profesionalisht me sistemin e ekonomisë, kontabilitetit, financave e ktu në Amerikë mirë u... u pasunova mirë dhe ndërkohë ma vonë pata fatin në mes lidhjes së një shoqës, në një firmë, në një firmë të avokatëve, shumë e madhe, të kaloj prapë në kontabilitet, departamentin e kontabilitetit ku sot e kësaj dite qe dhetë vjet punoj aty ku e kom gjetë vetën mirë.

Tash problemi i vetëm osht’ shëndeti, osht’ se s’kom probleme tjera familjare, të gjithë janë, disa janë ktu, vllaznit kanë ardhë, motra, fmitë e vllaznive, atje jonë mirë. Unë ktu kom kry disa, masandej kom kry disa kurse, disa gjana profesionale sa për me u, për me u profesionalizu ma mirë. Në punë punoj mirë, e kom gjetë vetën edhe i falënderohem shumë Amerikës që na ka mundësu jo veç mu, mu personalisht, familjes teme por edhe çka ka bo për gjithë Kosovën edhe çka po bon, tash, sot e tutje. Kështu kjo jeta jeme...

Besoj që kthehna në Amerikë. Ndërkohë mas luftës nime harrova me tregu. Mbas luftës, mbasi u stabilizun e kshtu, shoqnia që unë punoja me ata më thirrën në telefon edhe më thanë, “Lumka, duhesh medoemos m’u kthy”. Thashë, “Pse me u kthy unë tash?” Tha, “Me u kthy se duhesh me vazhdu aty ku e ke lanë”. Thashë, “Jo, unë mo në Kosovë [nuk] kthehna, muj me kontribu prej ktuhit sa prej atjehit. Luftë nuk ka, me luftu e me ndihmu s’kemi nevojë, ju jeni atje për me ndihmu”. “Jo, por ka,” tha, “vend edhe për ty”, thashë, “Unë s’po luftoj për vend. Unë ktu jom gjind shumë mirë, ktu tash kom nevojë unë veç me... kom nevojë me punu e me vazhdu jetën teme”. Kështu që ata... kom bo mirë që s’jom kthy (qesh).